

INTERVISTË ME FETAH BYLYTKBASHIN

Prishtinë | Data: 25 dhe 26 nëntor, 2024

Kohëzgjatja: 152 minuta

Të pranishëm:

- Fetah Bylykbashi (i Intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Adea Batusha (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Fetah, nëse mundeni me u prezantu edhe me na tregu diçka për kujtimet e juja t'para si fmi? Çfarë familje jeni lindë? Çfarë familje ka qenë?

Fetah Bylykbashi: Po, po, po. Unë ju tregova kur kam lindë dhe emrin e fshatit. Ni fshat... secili vendlindjen e don po ai ma i miri n'botë mu m'duket. Osht' me t'vërtetë gjeografinë e ka fantastike gjeografinë. Ni mal që gryka e malit kur ngjitesh përpjetë mrrin në atë Kleçkën, keni dëgju për Kleçkën ku UÇK-ja atje...

Anita Susuri: Po, po.

Fetah Bylykbashi: Në Kleçkë në krah të djathtë e në krah të majtë Duvlaka. Atje ka pasë strehime shumë të UÇK-së atje. Në njanën anë osht' burimi që mullinjtë kanë blu me ujë të ftohtë. Anën tjetër burimi tjetër me ujë të nxehtë që po ashtu shumë osht' kanë blu mullinjtë. Qaq shumë ka pasë. Ujitja e tokës... ai katun kurrë s'ka vujtë për bukë. Se mos me ra shi pikën ton verës aty ka pasë ujë. Aty unë kam fillu klasën e parë fillore n'katun timin.

Anita Susuri: Në Baincë?

Fetah Bylykbashi: Në Baincë po. Atë emrin ni odë të kojshiut që i përkiste familjes... se lagjet kemi qenë Lagja e Bylykbashëve, Lagja e Bajraktarëve, Lagja e Kolshve. Ai Kolsh ka qenë, ni Kolshi, se oda e tyne. Kem pasë ni mësus edhe ni msuse prej Gjakovës Hidajete ka qenë emrin e ka pasë ajo msusja. Aty nuk zgjati shumë në atë katunin, në atë odën e tyne por na dërgun në fshatin Shala e Drenicës, Sodllar i thojnë serbisht, Sodllar. Aty e kom kry klasën e parë e klasën e dytë e klasën e tretë, e të katërt, të pestën, të gjashtë, të shtatën, tetën.

Baba im ndjesë pastë, vendosi që me nanën me marrë edhe neve fmive, ishim tre vllazën e tri motra, gjashtë, e kemi shku jemi vendosë në ni fshat afër Magurës, Leletiq i thojnë. Po shumë, gati ngjit me minierën që është. Tani ma vonë, jo shumë kohë, kemi kalu bash në Magure atje. Kanë qenë ndërtesat urbane ato, po. E ruaj kujtimet shumë të mira, shumë të mira. Ka qenë ni profesor që klasën e shtatë

kom qenë atëherë. Bile e ka emrin shkolla në Prishtinë këtu Qamil Batalli. Qamil Batalli ka qenë arsimtar atje dhe ka organizu i pari, ka organizu i pari pjesë teatrale në atë katun. Po dihet çfarë kohe ka qenë ajo.

Kshtuqë ai ka qenë ni njeri shumë i madh. Unë tani kur jom rritë e kom kry e kom pasë njoftë po ai vdiq shumë i ri. Vdiq. Bile edhe para vdekjes përjetoj vajza e tij ni aksident e pat' humb jetën. Ka qenë shumë... i kem pasë arsimtarët e tjerë të gjithë kanë qenë me shkollë tetë vjeçare. Me shkollë tetë vjeçare. Kur kom kalu ktu në Magure në klasën e tetë aty ka qenë e organizune drejtori i shkollës serb, po. Arsimtarët ishin shqiptarë po edhe disa landë edhe në gjuhen serbe. E kom kry këtë shkollën fillore aty. Vujtjet kanë qenë shumë t'mdhaja për shkak të banesës për familjen tonë. Prej se e kemi lëshu banesën, shpinë tonë, kem pasë banesë dy katëshe.

Kemi qenë familje për t'keq në sy të shtetit. Axha im, Shefqet Kapetani, që njifet në popull me Rifat Berishën, me Brahim Banushin, këta të tre... Hasan Prishtina i ka organizu që m'i çu m'i shkollu në Shqipëri. Të tret kanë shku e kanë kry Akademinë Ushatarake në Tiranë, në kohën e Zogut, në kohën e Mbretit Zog. Kur e kanë kry atë shkollën tani janë angazhu në detyra. Ka qenë në libër t'vogël postri axha im si ushtar që ka shërby. Mirëpo mas ni kohe Mbreti Zog e ka ftu me qenë oficer i pallatit të mbretit. Oficer i pallatit të mbretit.

Ndodhi çka ndodhi Italia e pushtoj Shqipërinë edhe tash ata i çonte për me u... i çonte ushtarët në Itali për me u specializu për me u përsos në aspektin e profesionit ushtarak. Ai ka qenë tre vjet e gjysë në Romë. Me gruan, me fmitë. Bile baba i ndjesë pastë ka shku prej Drenicës, prej Bainces ka shku në vizitë dhe thonte, "E kom si kujtim t'veçantë që e kom mësu bicikletës me i grah atje", në Romë. Pastaj, kur filloj Lufta e Dytë Botnore kur filloj tash u kthy Italia dhe e pushtoj edhe Kosovën e pushtoj ma së pari. Qajo kohë që i thojshin Shqipëri, që i thojshin Shqipëri, edhe axha im kthehet në Prishtinë se e kishte graden kapiten, po. Në Prishtinë e ka pasë ni banesë, e ka pasë dikund atje përmu kuvendin ku ka qenë aty. Tash filloj tash lufta me Serbinë knena. Me Serbinë e me Bullgarinë filloj...

Anita Susuri: Mbretëria Jugosllave që ka qenë.

Fetah Bylykbashi: Po. Axha im me ni Dibrani ka qenë, Fuad Bekë Dibra. Ai ka qenë ni grad ma të naltë se axha im. Ka pasë edhe tjerë oficer. Po edhe shumë ushtar, shumë ushtar prej anës tonë të Drenicës që kanë shku me luftu po edhe baba im ka qenë. Po axha im me gru edhe grunë e ka marrë atje... Tugjec e atje kufini me Serbinë, Prapashticë e krejt ato vise, ai atje ka luftu kundër serbëve dhe kundër bullgarëve ka luftu. E tregonte gruja e tij, shumë e zoja ka qenë ndjesë pastë, ingja Hanë. Tregonte kur kanë shku ni katun e kanë pushtu aty, paska pasë edhe serb edhe shqiptarë aty.

Tha, "Derisa ishte Shefqeti", për burrin e vet, "t'u u përgadit për me shku n'detyrë trokiti n'derë dikush. Kur e qeli derën po e shof ni gru serbe me ato veshjet e tyne, fustana të fshatit", veshje tjetër kanë të fshatit. Tha, "Kish marrë me veti tana t'mirat e zotit. A po don arra, a po don ksi mjaltë, a po don ksi...

gjithfar' lloje të ushqimeve i kish pru", edhe tha, "Shefqeti pyti kush osht'?" Tha, "Ni gru ka ardhë me do sene. Gjithfar' lloj ushqimet". Del aty axha Shefqet dhe thotë, "Zojë, çka keni ardhë ju?" "Zotni kapetan kom ardhë me ju pru qito ushqime", "Zojë sa kushtojnë kto?" "O' zotni kapetan, unë nuk kam ardhë m'i shitë këto po i kom pru kshtu", "Ose tregoma çmimin ose merri e çoj te shpija". S'ja ka pranu.

Ingja Hanë thojke, "Mos t'ish kanë kapetani unë i kisha marrë", (qeshë). Bonte humor ajo. Ndodhi tjetra tash. Forcat komuniste tash u fuqizun forcat komuniste. Axhi im nuk e ka dashtë komunizmin, nuk e ka dashtë, kurrë s'e ka pranu, a po kupton? Thonte, "Komuniste s'ka sapun që e lanë. Komunizmi osht'..." Une shpesh i thosha, ndjesë pastë, "Shko bre axha Shefqet", krejt ato i shajke kujtime e ato. "Ku m'i lanë bre axhë?" "Po dikund vendosi", se isha ngat murit, "O' axhë, në socializëm edhe tulla osht' spihun", edhe qashtu ka qenë fatkeqësisht.

Tash vjen u shtu numri i komunistave. Axha Shefqet ka vendosë, ka vendosë, ka thanë, "Ma mirë të vrahën te une sesa të vrahën me qindra shqiptarë", se tash u deshke m'i vra komunistat. U deshke... nuk ish në parti komuniste, axha im, s'ka qenë. Ka ardhë prej Gjilanit atje, përte Gjilanit ka qenë kufini me Serbinë. Prej Gjilanit ka ardhë me ushtri dhe me armatim në katunin tonë aty. Tash këta dy shokët e axhës tim që ju tregova që kanë kry në kohën e Zogut që kanë shku në Shqipëri e kanë kry, ata dyt u bon komunistat.

Ky Rifat Berisha që e kishim si familjar... se gjyshi im ka pasë gjyshi im e ka pasë nanën të Berishëve. Ky edhe Brahimi, te dytë. Ai si ka ardhë aty kur komunistat fillun me u aktivizu axha Shefqet me baben tim kanë shku, janë strehu te disa miq të vet, janë strehu. Mos me u dorëzu, mos me ju dorëzu komunistave se ishte, qashtu ishin rrethanat. Në disa vende nuk kanë, s'kanë tregu bujari prej frikës normal, edhe ka gjetë ni lidhje në ni fshat Karaçic. Që prej atje shihet në mramje edhe Prishtina dritat edhe në Prizren shifen.

Ni nip i joni prej Kishnarekës, ni nip i joni ka pasë miqësi me ata të atjeshmit të qatij fshatit Karaçic thirret. Ai ka pranu, ka pranu. Për fundi shpisë t'tyne e kanë ba ni shpellë aty dhe aty janë strehu saherë kanë, që ju kanë çu ushqim e që kanë kontakti i kanë marrë bagëtinë, delet e lopët që ferkemat me i shly se UDBA e atëhershme ka qenë... edhe aty ni vjet jem strehu edhe axha Shefqet me babën bashkë. Se baba s'ju ka nda kurrë atij. Edhe ai ka pranu me u dorëzu. Ka thanë fjalën që e thashë përpara, "Ma mirë m'u vra unë sesa me i vra 100", a kumeditë sa aty. Janë dorëzu.

Axha Shefqet pastaj ka shku në burg në Kullën Sharamet. Kulla Sharamet ka qenë burg i tmerrshëm në Pejë, i Pejës osht' ajo. Aty ka qenë i burgosur. Pastaj ka qenë i burgosur në Prishtinë ni kohë të shkurtë edhe pastaj e kanë dërgue në Nish. Në Nish edhe në Smederevë edhe atje. Ka jetu... po mendoj në Nish edhe atje ka ba ky pesë vjet e ma tepër qashtu. Mirëpo shumë interesant që për pak me haru atë, asni ushtar i axhës Shefqet nuk ka guxu me sulmu dikond prej banorëve aty. As me vjedhë, as me... thonë, niherë ni edh e paskan dashtë me asi dhe ka marrë tash informatën prej... se ka pasë njerëzit. Ushtarak ka qenë ai ka pasë edhe përvojë të Italisë, merre me mend.

Kur ka... që ka qenë ajo rregulla në çdo mëngjes çdo ushtri i qet m'u rreshtu e me i pa. Me nder prej jush kur njani, "Qitne atje". Se ka pasë orë ai. Ai me trup ka qenë i vogël po ka qenë shumë i aftë në profesion t'vetin. Po. Qe tash po bllokohna kaniherë, po. M'ra në mend, shumë mirë. Kanë shku dy serb kur u bo gjykimi i axhës Shefqet kanë shkue. Kanë thanë, "Ky njeri sa ka qenë në shërbim atje askëndin nuk e ka, nuk e ka malltretu as s'ka lejuë me pasë me pësu dikush edhe na kemi veç fjalë t'mira për të". Mirëpo ajo s'mjaftonte, ato fjalë. Ai u burgos, u burgos. Ai ka bashkëpunue me këtë osht' i Gjilanit ai, ni figurë shumë shumë e rëndësishme. Hoxhë, hoxhë ka qenë...

Anita Susuri: Ai ka përmendore në Gjilan, s'po m'kujtohet as mu.

Fetah Bylykbashi: E përmendore. Ai ka bashkëpunu me të, ka bashkëpunu me të. Thonte, "Ni natë kur kom bujtë me të m'ka mbetë Kurani i përkthyn prej Hafuz Ali Korçës m'ka mbetë i përkthyn në gjuhën shqipe te Idriz Gjilani", Idriz, Idriz.

Anita Susuri: Mulla Idriz Gjilani.

Fetah Bylykbashi: Idriz Gjilani. Qe a p'e sheh. E kshtuqë edhe ai ka pasë autoritet t'madh. Qysh kom dëgju të anës të tyne thonin, nuk ka lis që s'e ka të shkrun emrin Shefqet kapetani. Domethanë...

Anita Susuri: A ka qenë pjesë e Ballit Kombëtar?

Fetah Bylykbashi: Ai ka qenë ushtar i Shqipëria që e ka organizue, Shqipëria që e ka organizue, po. Mirëpo disa kanë qenë me gjerman dhe disa me italian dhe ku ta di unë. Po ai komunizmin nuk e ka pëlqy kurrë dhe s'ka pranue me u bo komunist. Ata dy u bonën po ata dy e pësuan shumë keq, shumë keq e pësuan. Ky Rifat Berisha arriti me u bo edhe ni ministër. Po e ka pa që serbët nuk kanë besë, nuk kanë besë. Premtimet kanë qenë që kur të kryhet lufta secili me u deklarue a po don me Shqipërinë. Që u mbajtë mbledhja e Prizrenit. Atje në mbledhjen e Prizrenit... a mos je ti e asaj ane?

Anita Susuri: Po.

Fetah Bylykbashi: E tash i vetmja osht' ky, oha bre, ky i që ka... e ka kundërshtu dhe ka qenë 20 vjet në burg. I vetmi ai ka thanë, "Unë du me Tiranën, me Shqipërinë", e ata tjerët janë, kanë pranue ata të tjerët. E këta në burg 20 vjet ka qenë në burg me gjithë ni nip t'vetin, me gjithë ni nip t'vetin. Tani ka qenë i familjes të tyne edhe ky, ni profesor ka qenë ai, qe s'po m'kujtohet. Po edhe ai ka qenë, edhe ai ka qenë i burgosur. Bile atë ditën që neve na kanë lirue prej burgut këtu në Prishtinë... se unë edhe ai Ramadani 23 ditë kemi qenë në Gjilan. Se s'i kemi kry ato torturat që m'kanë bo mue.

Ni javë ditë... se po dalim prej ni teme ni temë. Ni javë ditë me Borova Voda m'kanë fshi, m'kanë la e m'kanë shëru. Pleh. Qysh osht' qikjo {i referohet ni objektit në ambient} zi trupin e kom pasë. S'mujsha as bukë me kapë as kurgjo hiç...

Anita Susuri: Deshta me ju pytë, ju m'thatë që tash për shkak të axhit t'juj ka pasë problem familja, osht' përndjekë...

Fetah Bylykbashi: Po, po.

Anita Susuri: Po fillimisht veç më tregoni a e kanë ekzekutu axhin?

Fetah Bylykbashi: Axha ka jetu. Axha u liru prej burgut masi i ka bo shtatë vjet, a nuk di, qe kom harru. U kthy në katun po vazhdimisht ka qenë i vëzhguar prej regjimit. Vazhdimisht, a po kupton? Mu s'më kanë dhanë si bursë nuk m'kanë dhanë veç pse jam djali i Shefqet kapetanit që ka luftu me ushtarë kundër Jugosllavisë. E kshuqë na kemi qenë... kur... janë do sene që masanej i vazhdojmë kur, po.

Anita Susuri: E në kohën e mbledhjeve të armëve se ju jeni '41-sh keni qenë fmi në atë kohë, sigurisht e mbani mend. Çka ka ndodhë me familjen e juv atëherë?

Fetah Bylykbashi: Me familjen tonë nuk, nuk e kanë, nuk e kanë arrestu këta, po mendoj axhën jo, po kojshitë tjerë po, kojshitë tjerë po. Ata nuk e kanë... as babën. Baba ka qenë në Lipjan nëpunës.

Anita Susuri: Mirë. Ishit t'u m'tregu edhe ma herët tash për shkollim e juv si fmi në Lipjan. Po du me thanë për pjesën kur keni shku në Lipjan me jetu...

Fetah Bylykbashi: Jo në Lipjan, në Magure.

Anita Susuri: Po në Magure, në komunën e Lipjanit. Si ka qenë atëherë?

Fetah Bylykbashi: Ka qenë tmerr. Tmerr ka qenë. Banesë ni banesë m'i thanë banesë po s'ka qenë banesë. Aty tani edhe në Magure kur zbritshim edhe atje ishte ni banesë me dy dhoma. Njanën anë ia kanë dhanë babës, njanën anë ni polic ka qenë i Llapit po ka shërby në Magure. Aty ka qenë shumë keq. Pastaj kur ka ardhë në Prishtinë na ka përcjellë fati... kur ka ardhë në Prishtinë në '61-shin... unë kam qenë në Prishtinë në normale. Kur ka ardhë e ka zanë ni banesë në Lagjen Pejton, qyteza Pejton. E ka zanë banesën.

Unë kur jom liru atë natë qat' natë që jom liru unë po shkoj te ni kusheri ka pasë punu në Kryq të Kuq, Bylykbash. Kusheri i imi, Vebi Bylykbashi. Ka pasë punu. Po i thom, "Baci Vebi, kur ka autobus për Magure? Për Golesh?" "O' bac", tha, "Bajrami me gru e me fmi e me krejt ka ardhë. Qitash po ta jep djalin t'çon se e kanë zanë ni banesë në Lagjen Pejton". As dy javë s'janë ba, as dy javë. Kah ka ni ai...

ka dëgju ai pronari i asaj shpijes që djalin Bajrami e ka politikisht të burgosur edhe e ka thirr, “Bajram t’lutna ni sahat e ma parë me ma lëshu banesën. S’guxoj me t’majtë se djalin politikisht e ke pasë t’burgosur”.

Emrin s’ja kom përmend kurrë, kurrë s’ja kom përmend. Ai mos me pasë dashtë babën tim s’ja kish lëshu banesën po tash ish, e ka mbrojtë vetën. Duhet me kuptu njeri se ka njerëz që ofendojnë mas të mirës që ia bon. Kurrë s’e kom bo ata edhe s’e boj. Thotë, “O’ s’ka e kanë lëshu, pa faj e kanë lëshu”. Ai thotë, “Meniherë”. Kemi dalë as dy javë s’kemi nejtë aty. Kemi shku pastaj në njo te rruga e vuqiternës në Prishtinë te hekurudha. Ajo banesë katastrofë edhe aty. Lypke banesë se baba tash filloj në ujësjellës ka punu prej Lipjanit në ujësjellës kur ka ardhë në Prishtinë.

Banesë nuk kishin. Tani ishte ni në Lagjen Nantjugoviç u thirrke ni lagje. Aty shumë shqiptarë kanë pasë shku në Turqi. E komuna s’ka pasë mjete m’i pagu ato po qashtu ju kanë mbetë komunës ato. Na kanë, qaty kemi gjetë na ni banesë. Ajo banesë, po ju them, Burgu i Gjilanit ka qenë ma higjienik sesa banesa jonë ku kemi jetu. Aty u smun t’gjithë përveç ni vllaut ma t’voglit. Baba edhe aty na vdiq në atë shpi, a po kupton. Baba 47 vjet na ka vdekë baba.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Nëse mundemi me bisedu për Shkollën Normale kur keni ardhë ‘57-ten.

Fetah Bylykbashi: Po ‘57-ten në klasë të parë.

Anita Susuri: Si kanë ndodhë rrethanat?

Fetah Bylykbashi: Në Shkollë Normale ka qenë me internat ka qenë. Kush ka banu aty ka pasë kushtet e mira. Edhe unë kam banu i falënderohem babës që ma ka mundësu. Po aty vazhdimisht kishte burgosje të nxanësve. Para neve, para neve u konë burgosë ni grup i normalistave. Bile njëni... unë kom shku në gjyq, kom shku kur u majtë gjykimi i tyre me shoktë e mi. Disa shokë që kam shku. Ka qenë fatkeqësisht ni drenicak, ni... ai dilke edhe akuzojke shokun e vet të klasës që me ni dhomë kanë flejt aty në internat. Se internati osht’ si ushtria. Unë ushtrinë e kam kry pa probleme se e kom pasë si jetë ushtarake edhe këtu.

Dile thojke, ky ka thanë qishtu, qishtu, qishtu kundër Jugosllavisë edhe unë kërkoj që ky të dënohet edhe s’di çka ju lypke ai, shumë i poshtër, shumë i poshtër. I kanë pasë burgosë njënin ni vjet, njënin gjashtë muj, njënin katër muj.

Anita Susuri: Cilin vit ka qenë ky?

Fetah Bylykbashi: Ka qenë para vitit...

Anita Susuri: Para juve ndoshta?

Fetah Bylykbashi: Para '60, pak para '60, '59-ten po i bjen. Qashtu. Tash saktësisht s'po m'kujtohet. Njëni, dyve ia di emrin se njanit ia kom harru ni Rifat Zhdrella, i Llapit ka qenë. Edhe njo ngat Barilevës ni Mehmet Çunaku. Ata dy kanë qenë. Ma përpara hala tjerë kishin pasë burgosë. Normalja ka qenë universitet ka qenë normalja për atë kohë. Ka pasë profesor... krejt profesorët që i kena pasë na fakulteti kur u hap, krejt kalun aty. Profesor e kem pasë këtë Rexhep Hoxhën, të gjuhës shqipe. Avdullah Zajmi të gjuhës shqipe. Demush Shalën të gjuhës shqipe. Krejt këta. Rexhep Hoxha shkrimtar.

Masanena histori Drita Dobroshi. Edhe Zekerija Cana ni kohë na ka dhanë ni kohë, po. Masanena këto landët e tjera psikologji edhe logjikë Pajazit Nushi, ai profesor ka qenë në Degën e Pedagogjisë. Ky biologji Faik Rizvanolli. Botanikën, ia harrova emrin, i Shqipërisë njani. Metodikën Tajar Hatipi. Beqir Kastrati gjuhën frënge, gjeni ka qenë ai Beqir Kastrati. Për tona landë kush mungojke ai i zëvendësojke. Ka qenë... matematikë na ka dhanë ky Mumxhiu, Hamet mumxhiu na ka dhanë. Na ka dhanë matematikë edhe Burhan Begolli i Pejës. Ka qenë kujdestar klase, ka qenë... Sadik Vraniçi ka qenë i edukatës fizike. Ka qenë i muzikës Jozefina Bala. Pastaj kanë ardhë disa tjerë kanë ardhë edhe ky që e ka djalë avokat tash i besimit të krishter, katolik.

Anita Susuri: Mark Krasniqi?

Fetah Bylykbashi: Jo, jo Marku jo. Ai ka qenë i muzikës, ia kom harru emrin.

Anita Susuri: Muzikë paska dhanë?

Fetah Bylykbashi: Po, po.

Anita Susuri: Kaçinari mos osht'?

Fetah Bylykbashi: Jo, jo. Lekë m'duket e kanë ata mbiemrin. Kanë qenë profesorët secili ma i mirë se tjetri e të sjellshëm. Edukator e kena pasë ni edukator i Malit të Zi.

Anita Susuri: Po m'intereson histori kush ju ka jep edhe çka keni mësu në histori?

Fetah Bylykbashi: Urdhno?

Anita Susuri: Histori kush ju ka dhanë edhe çka keni mësu?

Fetah Bylykbashi: Na ka dhanë Drita Dobroshi. Drita Dobroshi. Po ma vonë tjerve ju ka dhanë, ma herët ju kish pasë dhanë Ali Hadri. Ka qenë edhe ni tjetër i Maqedonisë ka qenë edhe njo, ia kom harru emrin po ai shkurt ka nejtë. Nuk ka, shkoj në Turqi ai.

Anita Susuri: Ju më tregut paraprakisht para se me bo intervistën për arrestimin e ju. Po po më intereson a keni qenë në ndonjë rast aktiv politikisht? A keni bo ndonjë aktivitet? Apo çka ka qenë arsyeja dhe si ka ndodhë krejt?

Fetah Bylykbashi: Po, kshtu, në '58-ten ka pasë përpjekje për me organizu ni demonstratë kur u burgos Adem Demaqi. Qiky Ramadani i Ferizajit osht' ajo, tash po përdoret ky termi që përpara s'kemi dëgju, kimia. Kimia i bashkon njerëzit, kimia. Ku e fitoj ai besimin mu me m'thanë, "Do me u majtë ni protestë, ka me u mbajtë po a don me ardhë me marrë pjesë?" Thashë, "Po". Une kom pasë orientim prej familjes une, s'kom dashtë une pushtimin as s'kom dashtë as s'jom kanë në parti asniherë s'jom kanë apsolutisht. Po kemi shku na me i përcjellë... Ramiz Cërnica osht' ai që ka thanë, se m'ra n'mend, që ka thanë, "Me Tiranën du". Ramiz Cërnica i vetmi.

Une kom shku... se i qasaj familjes osht' kanë njëni kur u burgosë ai edhe kur ka qenë në gjyq unë kam shku me qata shoktë me dëgju në gjyq. Ai osht' baba i kësajna grusë të ktina Brestovci, jo, qysh e pat' emrin more këta? Ai rektori që e rrehën studentët kur e zunë, kur e organizun këta... Ejup Statovci. Gruja tash osht' gruja qajo gruja e Ejup Statovcit osht' vajza e qatij kusherinit të Ramiz Cërnicsës po ia kom harru emrin. Ai shumë i zoti. Bile atë ditë kur na lshun ai shefi i policisë ka qenë ni Çeta Popolloviç. Ai ma i madhi ka qenë për udhen në Kosovë.

Tha, "Na kemi mendu që ju jeni, ju jeni anëtarë të partisë të...". qitina që po ia harroj emrin unë, qitina të Gjilanit, po, tha, "na kemi bo përpjekje qysh m'kanë thanë", tha, "hetuesit", ata që na rrihnin, që na torturojshin. "Qysh m'kanë thanë", tha, "po na s'kemi mujtë me vërtetu që keni qenë anëtarë". Mu m'u ka drejtu personalisht tha, "Kqyre, hetuesit m'kanë thanë që je shumë kokëfortë", thashë, "Nuk jom kokëfortë po të pavërtetën kurrë s'e pranoj". Saherë m'kanë torturu ju kom thanë, "Vramni po prej meje kurrë fjalë tjetër s'keni me ba se nuk e akuzoj njeriun që s'ka bo kurgjo, nuk e akuzoj. Urdhnoni më vrani", "Po ma bre, je i ri". Disa më rrihshin po ka pasë edhe që s'më kanë rreh. Krejt taktika të tyne.

Tani njo i Obiliqit po i thom Ramadanit, "Ramadan, qiky s'më ka rreh", tha, "Qiky mu ma së shumti m'ka rreh". Aty te dera t'u pritë. Kshtuqë mu m'thojshin, "Qe bre e kemi veturën në oborr të burgut e kemi, qitash po t'çojmë veç prano. Dil e thuju qatyne shokve që s'e ke qit ti flamurin po e ka qit Ramadani po ju e keni shoqnu. Qitash po t'çojmë n'katun atje te nana, te baba, te vllaznit", "Kurrë s'e pranoj, kurrë s'e pranoj". Kurrë s'kom pasë shtrat une. Une kom flejt 23 ditë... janë do fshisa, janë do fshisa, dorëzen e shkurtë e kanë. Ka me bishtë të gjatë po ato të shkurtë. Në qasi e qitsha në qosh qashtu u ulsha, qashtu unë kom ba gjum 23 ditë. Përveç që i kam shënimet saherë m'kanë çu edhe në qeli, a kupton? O' zot i madh, o' zot i madh. Qishtu.

Anita Susuri: Po ju a organizut qat' protestë a çka ndodhi? Se mbetëm aty.

Fetah Bylykbashi: Jo, e tash, e tash, po, mirë bone se s'e përfundova. Ka ardhë, interesant, ka ardhë në gjystë të natës ka ardhë te kreveti jem... kena pasë kaniherë dy katëshe, po, tani dikur u lirun kish hapësirë ma shumë. Ka ardhë m'ka ardhë, "Fetah, u anulë", tha, "protesta se kemi informata që osht' rrezik shumë i madh atëherë mbyllen krejt shkollat në gjuhën shqipe", serbët qata e kanë dashtë. Edhe e kanë anulë qat' protestë. Mirëpo përherë jemi, kemi, kem pasë shpirtin kombëtar. Po.

Anita Susuri: A keni bo ndonjë aktivitet tjetër? Kta me flamur nuk e keni bo?

Fetah Bylykbashi: Jo, nuk e kemi bo, nuk e kemi bo. Po njëni që m'ka akuzu mu, njëni që m'ka akuzu mu, se kta dy shokët këtu, kta dy shokët Faiku me Vebiun ktu në Prishtinë i kanë nalë. Kur na kanë lëshu neve, mu edhe Ramadanin, kur na kanë lëshu atë ditë, ata e kishin pasë... s'ua kishin shkurtu floktë as... kishin pasë tesha, shtrojë e mlojë. Baba im i kish pru, i kish pasë pru po s'ja kanë pranë. Në Gjilan i ka çu teshat me sene, ushqim e sene as s'më kanë pru teshë as kurgjo. Unë ton kohën n'burg kom nejtë me qat' xhemper, me niparë pantollë edhe qat' kmishë.

Anita Susuri: A keni pasë naj vizitë? A e kanë ditë për shembull familja ku jeni?

Fetah Bylykbashi: Masanej, masanej. Baba kish pasë vendosë kur kish dëgju që m'kanë burgosë kish pasë thanë, "Du me shku në Prishtinë s'kanë nevojë me harxhu benzinë UDBA për me m'i burgosë fmitë e mi". Babën tim merre me mend e kanë akuzue se ai përveç që ka kry, po mendoj, ka qenë administrator po ai ka ditë edhe me maqinë me shkru. E tash maqina e shkrimit që e kanë prodhue fabrikat e ka ni pjesë të shiritit të kuq e ka ngjyren. E kanë akuzu që ti je anti jugosllav se edhe këtu e ke qit' flamurin, flamurin e ke qit' kuq e zi. Qishtu.

Anita Susuri: E pastaj ju m'tregut kur keni dalë prej burgut...

Fetah Bylykbashi: Po. kur kemi dalë prej burgut na kanë thanë, "Jeni të lirë", po.

Anita Susuri: T'pafajshëm jeni shpallë?

Fetah Bylykbashi: T'pafajshëm, po. Na ka shpallë në komunë aty njo, ni shqiptarë na çun...

Anita Susuri: Në Gjilan apo në Prishtinë?

Fetah Bylykbashi: Jo, jo në Prishtinë, në Prishtinë, po. Ni Ali Reçica. Na ka thanë, "Ju jeni t'lirë". Ni vjet s'na kanë dhanë t'drejtën me hi në provime të diplomës. Ni vjet kemi bredhë qashtu. Mas ni vjeti, mas ni vjeti kemi hy në provim të diplomës, kemi kry diplomën. Janë sillë shumë mirë profesorat me neve, po. Unë jam, kom fillu punën me 20, me 15 shkurt të vitit 1962, '62. E baba ndjesë pastë, i thotë... ni

Metush Ballabani ka qenë edhe udhëheqës këtu në Prishtinë në Lidhjen Socialiste ka qenë ni autoritet ai. Po edhe atje në komunë të Lipjanit, kryetar ai.

I thotë, “O’ Metush ku me çu bre Fetahun në detyrë?” Ai thotë, “Aii bre”, thotë, “mos më lodh pashë zotin, po çu n’qat’ Drenicën tane që asnjë ni tetë vjeçare s’e kanë”. I thotë, “O’ Metush mos më kallxo ti mu për Drenicë. Në Drenicë me pasë bisht familja jonë, ta kpusin, mos me pasë ta ngjesin. Na jemi në sy të pushtetit se vllau jem ka qenë kapiten i ushtrisë e ka luftu kundër Jugosllavisë”. I thotë, “Ta gjeta vendin”. E kom kujtimin që s’e harroj kurrë. “Në Janjevë po e çojna. Katolikët nuk ta ngjesin pa kanë. Në Janjevë po e çojmë”.

Anita Susuri: Shumë interesant.

Fetah Bylykbashi: Kur kom shku në Janjevë tash, interesant ma së interesanti.

Anita Susuri: Zoti Fetah, bisedum ma herët ditën e djeshme po mbetëm te pjesa kur ju keni fillu me punu në Janjevë.

Fetah Bylykbashi: Po, po, qe tash e vazhdojmë. Në Janjevë ju thashë se kom punu vetëm ni vit, ni vit. Ruj kujtime të jashtëzakonshme, të jashtëzakonshme. Janjeva e ka pasë, ka pasë shumë banor, shumë banor. Pesë dyqane të mishit kanë qenë. Dy komunistë kanë qenë, dy anëtarë në Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë. Që dul ajo fjala e kryetarit të komunës që i ka thanë babës, “Ta gjeta djalin ku me çu. E çojmë në Janjevë se ata katolikët nuk ia ngjesin pa kanë”. Kshtu.

Kam pasë t’fesë, të besimit katolik prej nxanësve kam pasë, po. Prej ni fshatit vinin, Brus, ni fshat osht’ Brus, vinin. Unë, e tash, aty kur fillova punën m’pyti drejtori që ishte ni malazez, po. M’tha, “Cilat landë dëshiron m’i marrë?” Thashë, “Qato që janë t’lira”. Tash unë s’dojsha me ua marrë njerëzve që ishin aty, po. Ai tash edhe ni tjetër po e tregoj shumë shkurtë. Ai kur m’pyti, “I kujna je?” I tregova, “I Bajram Bylykbashit”, tha, “Unë babës tond, se ty po të shoh po t’njoh, babës tond i kom borxh”. I rrodha krahët. Tha, “Ai në Magure ka punu si nënpunës...” Edhe Magurja ka qenë si komunë e vogël. “Unë e kam kry shkollën e lartë pedagogjike në Shkup histori, gjeografi. Lidhje me administratë... krejt administratën ai ma ka kry”.

Landtë i kom marrë katër landë. Gjuhën shqipe, gjuhën frënge, edukatën fizike dhe edukatën muzikore. Besoni e kom majtë gjuhën frënge, sot s’di. Ata fmitë ma shpesh shkojshin në ksi, në kishë sesa në shkollë. Po...

Anita Susuri: A ka qenë n’atë kohë shkolla afër kishës aty ni objekt që ka qenë apo ka pasë objekt të veçantë? Se e di që ka qenë nifar’ si...

Fetah Bylykbashi: Ka qenë pak ma tutje ajo, a shkolla e ka pasë... po ni shkollë primitive, ku ta di unë. Aty kom kalu, ishte ni vend i mrekullueshëm. U kultivojshin të gjitha pemët e perimet e të gjitha... dhe jemi ushqy unë me gjithë qat' drejtorin jemi ushqy... ai e kish pasë ni banesë tha, "Ti ki me ardhë me banu", tha, "me mu", tha, "po i kemi dhomat e veçanta dhe ki me u ushqy me ushqim prej kishës". Ishte ni enë që i kish tri porcia për supë, sallatë edhe gjellë. E pagujshim. Ai djali i atij i zotit të shpisë shkonte në kishë i merrte na binte. Kshtuqë ruj kujtime të jashtëzakonshme.

Jom nda me ata fmi dhe a beson, ata fmi kur janë rritë masanena kanë ardhë m'kanë vizitu disa herë. Njëni prej tyne kishte shkru ni libër, ishim në Komunë të Lipjanit para tre-katër vjete edhe kish shkru ni libër dhe m'kish cekë mu për punën që kam kry. Erdh ma pruni librin dhe tha, "Po kom qef m'u fotografi". Për shkak të udhëtimit unë kam kalu në Hade. Hade. Ai baci Ymer, ndjesë pastë, ai ma ka siguru mu, po jo në Hade, po në drejtori të Hadës e Shipitullën që ua përmenda. Në Shipitullë kom shku dhe e kom marrë komplet klasën e pestë. Se klasën e pestë e kish pasë udhëheq njëni dhe ai kish kry juridikun tani kish shku n'profesion t'vetin. E kom udhëheq atë ka dalë ni gjeneratë e mrekullueshme.

Por, çka kom vërtetë aty që e kom kry në detyrë shumë sipas meje, vlersomna edhe ju ose akuzomni. Qitash ni digresion shumë t'vogël p'e boj. Kur kemi shku për vizitë kemi hy në orë të mësimit po përpara i kemi marrë planet, i kemi ditë orët mësimore çka ka. Kemi hy në orë të mësimit edhe kemi vëzhgu si po e organizon hyrjen, pjesën qendrore dhe përfundimtare. Kur kom bisedu pastaj për të i kom dhanë mendimet e mija. "Kolegë, pse jom une këshilltar nëse ti ki argumente se s'jom unë i gjithë dijshtëm, lirisht ti më korigjo. Nëse unë e kam gabim unë të falënderohem ty shumë". Kurrë kërkanin nuk e kam...

Për shembull dikushin me refuzu ata kishe jam unë dikushi edhe ka përdorë metoda të palejueshme edhe jo njerëzore. Tash, çka osht' ajo që në orë të mësimit në orën e mësimit të edukatës fizike saherë kishim i nxjerrsha jashtë, varësisht kur ish koha jo e mirë, i nxjerrsha jashtë organizojsha loja. Po vrejsha se disa nuk shoqërohen me disa tjerë. Cilët ishin ata? Muhaxherët që ishin në atë katun aty Bërbatovc e ku ta di unë ata që i ka përzan Serbia në '87-ten dhe kanë ardhë. Tani ai pushteti ua ka marrë ktyne vendasve tokën dhe aty tash janë ngjallë ato urrejtjet mes tyre.

Unë i kam bindë që na jemi shqiptarë, na e kemi ni gjuhë, na duhet me dashtë njani tjetrin. Kjo nuk osht' n'rregull dhe kurrë s'i kom lanë ata, ekipin me formu qysh dojnë ata po qysh kom dashtë unë me qëllimin ma t'mirë. Kshtuqë edhe kom arritë, kom arritë me realizu shumë me sukses. Besomni qaq e kom respektu detyrën, unë kom udhëtu prej Prishtinës deri në Fushë Kosovë, prej Fushë Kosovës në tren që shkon për Pejë deri në Grabovc i thojnë, aty ka qenë stacioni. Ka pasë raste që treni nuk ka shku atë ditë, Fetah Bylykbashi n'kamë prej Fushë Kosovës nëpër Ballaqevc, nëpër Grabovc e në Shipitullë kom ardhë me majtë orën e mësimit edhe qizmet me baltë m'u bojshin.

Ato ma kanë vlerësu me popull me të gjithë. Tash mos ma merrni për kshtu... para sa ditësh vdiq ni vlla i dhandrrit tim i Drenicës, Zariç, Zariç janë. Shkova unë, shkova me kusherit e mi shkova me pa. Kur shkova erdhën miqtë e tyne të Zariçve që kishin informata për mue. Kur e përmendën, kur ma përmendën emrin mue, njani që kish dëgju për mu u çu n'kamë tha, "A ti je Fetah Bylykbashi?" "Po", thashë, "Po ti bre je gjeni", çka s'foli. Po ju drejtohet atyne, "Ktina ni bust duhet me ia ndërtue", thashë, "Jo, jo nuk osht' ashtu. Jom mundu me gjithë sinqeritetin tim". Kshtuqë ku kom punu, ku kom punu...

Pjesa e Tretë

Fetah Bylykbashi: Shkova në Shipitullë po. Po e vazhdoj tani ku kom shku tjetër kund. Aty kom punue rreth tetë vjet, tetë vjet. Përfshito ushtrinë që jam kanë ni vit e gjysë ushtar, po. Në vitin 1970 u shpall ni konkurs në Fakultetin Juridik, u shpall ni konkurs. Në të vërtetë ma përpara u shpall në Shkollë Normale ni konkurs me qenë referent i nxansave. Shkova ni javë ditë edhe ai sekretari tha, "Ti çka dush bon ti". Po ndërkohë u shpall ni konkurs për përkthyes në Fakultet Juridik. Jam pranë. Aty kom punu pesë vjet, si përkthyes.

Pas '76-tes, në '76-ten u shpall ni konkurs në kopshtin e fëmijëve për me pranë ni pedagog për kopshtin e fëmijëve aty. Konkurova, u pranë. Kom punu aty në dy gjuhët kom punu. Ju thashë që përfshirja në atë kohë ka qenë 0.86%. Merre me mend çfarë padrejtësish u bonin. Drejtoreshë ka qenë motra e Fadil Hoxhës, Myrvete Limani ka qenë. Thom, "Drejtoreshë struktura e popullsisë osht', e dijmë qysh osht'". Titoja e pat' majtë në Split ni bisedë, ni fjalë atje që folke në favor të shqiptarëve. Se ka qenë përpara ai Rankoviçi. Ai ka qenë xhelat, xhelat i shqiptarëve ka qenë. Ai e ka organizu atë rrahjen... mbledhjen e armëve e krejt ato krime ai i ka ba.

Kshtuqë, "Të respektohet struktura e popullsisë". Drejtoreshë pastaj edhe ajo shumë ka qenë korrekte. Edhe filloj me u shtu numri i fëmijëve të përfshirë në krahasim me fmitë e serbëve. Tash aty në kopsht të fmitëve, në kopsht të fëmijëve, kur kom punu kom punu në dy gjuhët. Kur... si hysha në mëngjes e vizitoja të gjitha ato dhomat, fmitë i vizitoja dhe kur hyja aty ku kish edhe serb ma së pari shqip i përshëndetësha, "Mirëmëngjesi", po edhe n'gjuhën serbe. Ka qenë ni motër medicinale që kurrë s'ma ka kthy përgjigjen kurrë. Jo kurrë po nja pesë-gjashtë muj, a unë timen e maja. Mas pesë-gjashtë mujve kurrë ma unë s'kom mujtë me përshëndet i pari.

Kshtuqë ka pasë serbe edukatore edhe nga Vojvodina ka pasë. Ato janë qaq, tjerë serb janë ata të Vojvodinës. Atje ka sundu në Vojvodinë Austro Hungaria. Kurse ku ka sundu turku shkrum e ka bo, shkrum bre, zi e shkrum. Fatkeqësisht, ty dje m'dukët të thashë kur dolëm aty, thashë pse unë emrin Fetah me pasë? Qe 100 vjet ka shku Turqia. Me çfarë të drejte? Unë s'i urrej turqit në vend t'vetin po pse me m'shelë dikushi, deri kur do t'na shkelë dikushi? Se jom shumë n'këtë aspekt... na n'familje kemi qenë armiq të pushtetit kemi qenë. Familja jonë ka qenë e trajtune si armike. Ku e pata se...

Anita Susuri: Te puna në kopsht.

Fetah Bylykbashi: Te puna në kopsht, po. Kemi organizu, kemi organizu orë mësimore, kemi hospitu me drejtoreshën. Saherë kom shku i kom thanë, “Hajde eja bashkë”. Nganjëherë u konfrontojshim se ajo e kish të krye shkollën histori gjeografi në Maqedoni e unë e kisha... se na pedagogët kemi qenë për shembull të Entit Pedagogjik ma të ngarkumit. Se na e kem pasë mësimin klasor. Mësimi klasor të gjitha landët i ka përfshi. Kurse këshilltarët e tjerë që kanë qenë të mësimi landor, e kanë pasë gjeografi ose matematikën ose muzikën, kshuqë veç ni landë. E na kemi qenë shumë të ngarkun.

Bile tash p’e ceki n’këtë moment se unë e Halim Hyseni kemi qenë ma të ngarkumit në kit’ periudhën çka na gjet’ atëherë, ma të ngarkumit. Halimi ka qenë drejtor i Entit Pedagogjik të Kosovës, unë kam qenë drejtor i Entit Pedagogjik të Prishtinës. Por, po ju tregoj edhe tjetrën që... ma së pari, si kemi vendosë na shqiptarët me vazhdu punën e Entit Pedagogjik e kemi zgjedhë Vagjit Nuredinin e Preshevës. Vagjit Nuredini ka qenë drejtor i shkencës të pedagogjisë. Po ka qenë në Ent Pedagogjik, nuk ka qenë këshilltar i terrenit por analitik ka qenë. Ka punu punë analitike.

Besoni, as dy javë s’e ka majtë atë detyrë. Tash s’po du me dhanë komente, problemet e tij. A u frikësu, a s’u frikësu unë apsolutisht nuk jam frikësu për punën se kush do ta mbron këtë popull nëqoftëse na s’e mbrojmë, nëqoftëse na s’e mbrojmë. Ai e lshoj. Gjete ni arsye dikund shkoj. Kta tjerët më propozuan Fetah Bylykbashin. Unë e kam pranë. S’ka detyrë që Fetah Bylykbashi ka refuzu në interes të arsimit, s’ka detyrë. Me një, me një tjetër ni anena i Dukagjinit, bash, siç e thashë ky katuni që kom shku unë me majtë fjalim, i Dukagjinit, Istogu.

Njo i Istogut, po, që e kom njoftë edhe prej Shkollës Normale. Ai ma së pari e formoj këtë këshillin për financim për arsim dhe u bo ai drejtoj. Mu më angazhun aty me ndihmu, po...

Anita Susuri: Cili vit ka qenë?

Fetah Bylykbashi: Po meniherë ‘91-shi, ‘92-shi meniherë. Po. Meniherë, meniherë janë fillu këto sene. Tash unë e kisha detyrë drejtorin, e kisha detyrën e këshilltarit që e kryjsha, a po kupton? Tash isha edhe aty anëtarë i atij këshilli. Tash po m’thotë, “Bonu ti drejtor se une po du me shku”, “Ma bre”, thashë, “ma bre se s’mundem m’u shky n’tana antë jo që s’po du”. Aty tani erdh ni tjetër drejtor e ma vonë përsëri mu më angazhun, ata si e tregova, ni mandat veç anëtarë u deshke me shku me majtë fjalim m’i bind, për shembull, shoqatën e juristëve, kta të avokatëve.

Tani te Ramiz Sadikut kanë qenë, tani të ktyne rrobaqepësve tani gjithkrah me u interesu për arsim me siguru diçka. Kur shkova aty në këtë shoqatën e juristëve ata shumica, shumica premtun 1000 marka, markë ka qenë atëherë, po. Po kish edhe disa që kaniherë edhe unë u detyrojsha me shku me këtë financierin si anëtarë që isha që me shoqëru ata, me i thanë që qishtu ke premtu kur e kemi majtë takimin. Këto punë kurrë, kurrë, kurrë s’janë nalë deri në ‘95-ten. Në ‘95-ten u murr ni vendim në nivel

të Kosovës që entet pedagogjike me i mbyllë. Drejt me të thanë une me Halimin e kemi kundërshtu edhe disa tjerë edhe ni pjesë e madhe e kemi kundërshtu.

Tash u formun këto drejtoritë komunale të arsimit, drejtoritë komunale të arsimit. Ai vendimi qashtu diçka shkrun. Kur u formun këto, atëherë u bo ni organizim tjetër, organizim tjetër. Aty na pat' u bo tani ni përqamje e Entit Pedagogjik. Se Enti Pedagogjik na shqiptarët tanë ishim edhe du ta ceku që ndihmë ma t'madhe na ka dhanë Sadri Fetihu, drejtor i Institutit Albanologjik. Ai na ka siguru ni dhomë atje niherë në javë. Na çdo javë kemi mbajtë mbledhje me këshilltarët. E kemi, e bojshim raportimin qysh, detyrat dhe planin për javën që vinte. Qashtu i kom të shënune.

E shënojsa kush po merr pjesë, e kush s'po merr pjesë. Janë majtë evidencat. Kemi qenë shumë, shumë serioz, shumë serioz. Kjo ka vazhdu e kur erdh puna që u formun këto drejtoritë komunale të arsimit më propozun përsëri unë me vazhdu si drejtor. Thashë, "Faleminderit..."

Adea Batusha: Zoti Fetah më fal që po të pyes, pyetje teknike, si drejtor i Entit Pedagogjik qysh u kanë e rregullune qikjo? Edhe Halimi, zoti Halimi u kanë në qit' periudhë. Qysh jeni kanë të ndan? Puna qysh u kanë e ndane?

Fetah Bylykbashi: Po ai ka qenë në nivel të Kosovës, ai e ka kontrollu krejt Kosovën a unë e kom kontrollu, për shembull, unë kom mbajtë mbledhje me drejtorët e arsimit të Prishtinës, të komunës së Prishtinës. Unë e Halimi. Kemi mbajtë shumë shpesh mbledhje të përbashkëta. Halimi ka qenë niherë këshilltar, dytë kemi qenë. Po shumë kujtime t'mira. Është... e ka ni cilësu. Ma kavalër se në shoqëri si ai... unë i thojsha, "Nëse fitoj naj here në llotri s'ka me t'lanë me shti dorën në xhep kurrë ti" (qeshë). U humoritsha me të.

Ai ka qenë drejtor, po, qashtu. A në Lidhjen e Arsimitarëve Shqiptarë kemi qenë Rexhep Osmani kryetar, unë sekretar, Halimi me kta tjerët kanë qenë anëtarë, Hajrullah Koliçi ka qenë anëtarë. Ka qenë ky...

Adea Batusha: A ke qenë prej fillimit sekretar?

Fetah Bylykbashi: Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë osht' themelu me 12 dhjetor '99-tes, me 12 dhjetor në sallën e filologjikut, aty osht' mbajtë tubimi. Ka pasë edhe Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë ka qenë në nivel krejt Jugosllavisë, krejt shqiptarëve. Nuk ka qenë veç për Kosovën. Ka pasë ni jehonë shumë t'madhe. Drejt me të thanë kish ka pak do devijime. Une, qiky Halimi kur u formu këshilli financiar aty në kuadër të Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë po m'thotë, "Fetah, po du me të propozu ty", thashë, "Halim, mos më pshtjell. Në financa s'kom qef se aty bon vaki të ngjitet edhe pa e ba hiç, a po kupton? Tha, "Po du se e di që vallahi nuk bon ti diçka t'keqe aty", e pranova.

Besoni mas, s'po di sa mujsh, ia nisëm shumë mirë. Vishin kto informatat prej venit tonë kush jepke kontribut për arsim. Vishin prej viseve tjera, prej Preshevës, prej Maqedonisë, vishin ndihmat. Vishin

prej Zvicrrës kta anej që ishin jashtë. Tash, fillim si osht' ma mirë me i regjistru kah erdhën. Kush erdh, sa erdhen. Hajde tash cila shkollë ka përparësi me marrë këtë ndihmë. A po kupton? Shkoj. Mas ni kohe Fetah Bylykbashin s'e thirrke kush në mbledhje, hiç. E mbajshin vet mbledhjen ata tjetër. Une prej ni mbledhje që e kishim na Shoqata Naim Frashëri edhe thashë, "Unë jap dorëheqje nuk du me qenë veç formalisht. Unë kom pranë me punë në mënyrë të sigurtë, nuk po shkon puna". Më kritikun disa. Tani ni Neriman Braha ka qenë edhe ai anëtarë. Une...

Adea Batusha: Çka ka ndodhë se s'pe kuptoj, çka u kanë mosmarrëveshja?

Fetah Bylykbashi: Mosmarrëveshja ka qenë që s'më kanë thirrë mue.

Adea Batusha: Po pse ka ndodhë kjo?

Fetah Bylykbashi: Po pse nashta ia kom prishë hesapet nashta. S'ka aty, po dihet ajo punë, po. Kur unë i kritikova ata aty, kërkush s'më mbrojt. Po e takoj qat' Neriman Brahën te gjygi bashkë me bacin Ymer që e përmende ma herët. Po m'thotë, "Fetah", tha, "plotësisht ke pasë të drejtë", Nerimani, "ke pasë të drejtë po nuk osht' koha tash". Thashë, "Neriman, le bre tash mos folë. T'ka taku atje n'vend me folë e atje s'ke folë". Po në përgjithësi u kry ni punë e madhe. Kemi punë me sinqeritet. Shumica kanë qenë shumë në nivel, a po kupton. E kemi dhanë ni provim, ni provim të duhur.

Mbledhjet i kemi mbajtur me rregull. Mbledhjet i kemi mbajtur me rregull. Hospitimet i kemi mbajtur me rregull. Vazhdimisht raportet i kemi shkruar kur kemi... se në Ent Pedagogjik na që kemi qenë të terënit na kemi pasë detyrë me shku me pa gjendjen prej derës së oborrit të shkollës deri në kulm të shkollës edhe krejt aty u duft me evidentu. Kanë qenë katër forma të monitorimit, se di a e dini a s'e dini. Kanë qenë dy forma. Forma të kontrollimit. Kontrollimi ka qenë në fillim të vitit shkollor dhe në fund të vitit shkollor. Kontrollimi në fillim të vitit shkollor e kontrollojshim a janë pregaditë krejt edhe ana pedagogjike edhe fizike edhe gjitha. Kjo e higjienës e të gjitha ato dhe kemi raportu. Në qoftëse s'u përgadit shkojke... se na...

Për shembull Zijadinin a keni bisedu? Zijadini ka qenë sekretar për arsim. Ai ka qenë i organit ekzekutiv. Entet pedagogjike janë organ këshillues, organ këshillues. Na kem pasë të drejtë me propozu nëse naj njëni... përkundrazi që po ndihmojmë si këshilltar nuk ka sukses kemi pasë të drejtë me propozu qitij organi që me largu prej punës, po s'e kemi bo ata kurrë niherë s'ka ndodhë.

Anita Susuri: Kisha dashtë me u kthi pak te vitet e '80-ta para se ka ndodhë krejt kjo. Se ju jeni... deri kur keni punu...

Fetah Bylykbashi: Kadal kadal se m'ka ra në mend diçka mue dje që m'ke pyetë m'ka ra ndërmend. Fetah Bylykbashi prej nipit tim e kom marrë librin e Gjergj Fishtës Lahutën e Malsisë. Qajo ka qenë me

t'kallë Serbia me krejt me ta gjetë ata. Unë e kom marrë atë libër edhe e kom shkru gati krejt e kom shkru me ni fletore edhe ia kom kthy, se u dashke me kthy ata.

Anita Susuri: Keni qenë nxanës...

Fetah Bylykbashi: I klasës së tetë fillore, i klasës së tetë fillore hala pa shku në normale. Masnena kur kom shku në normale gjithçka ndëgjoja prej axhës tim, Shefqet kapetanit, prej axhës Shefqet. Ai e kish ni njohuri e ni kulturë për Shqipëri, për Itali e për gjithçka. Ai thonte se Leka i madh, Aleksandri i madh ai osht' shqiptarë osht'. Ky i takon rranjëve shqiptare. Unë e kom pytë, m'fal emrin qysh e pate?

Anita Susuri: Anita.

Fetah Bylykbashi: Anita. E bajsh me shëndet e me nder i bajshi. E Anita unë tani i nijsha prej axhës po tash dojsha te profesoresha e historisë me pytë a din. "Profesoreshë Aleksandri i Maqedonisë a ka qenë shqiptarë a maqedon?" Tha, ajo ma ktheu ni përgjegje, kshtu pa takt. Tha, "Kur kom mësu unë ka qenë shqiptar, tash osht' maqedon", (qeshë). Ndjesë pastë. Merre me mend, edhe n'klasë kish pasë spihuna prej nxanësve. Kur... qat' burgun ju tregova. Kur kom shku aty në pytje tjera m'kanë thanë, "Çka ka thanë profesoresha e historisë? Qysh e ke pytë ti?" E kom pytë qishtu, qishtu ka thanë. Po du me thanë që kish pasë plot spihuna, kish pasë n'tona antë.

Tjetër kena pasë këtë Avdullah Zajmin i Vushtrrisë ai. Shumë bre t'mirë kanë qenë ata profesor, o zot i madh. Edhe ata e pytshim e ai... diçka për shkrimtarët a... po. Ai thojke, "O' djema, ni varr që ka qenë, ni varr që ka qenë ka fillu ni lëkurë tash e re me dalë mos grrithni tash, mos e grrithni". Po unë dojsha pa kurni djallëzie, veç me ditë çka... a ka të drejtë axha Shefqet i jemi a jo. Kshtuqë ata edhe qat' ditë që ka marrë vesh baba m'kanë kallxu kur jom dalë prej burgut. Si e ka marrë informatën që jom i burgosur me shokë meniherë e kanë djegë atë. Se janë frikësu që po shkon UDBA aty dhe po kontrollon dhe p'e gjen atë fletoren e Lahutës së Malësisë, e kanë djegë. Qishtu.

Anita Susuri: Deshta pak me folë për vitet e '80-ta. Keni punu po ka qenë pastaj edhe demonstratat e vitit '81, protestat. Qysh ju kanë gjetë krejt këto edhe ku jeni kanë t'u punu atëherë?

Fetah Bylykbashi: '81-shi jom kanë në Ent Pedagogjik .

Anita Susuri: Prej cilit vit jeni kanë në ent?

Fetah Bylykbashi: Unë në Ent Pedagogjik prej vitit, që e kom qaty dikund, deri '99-ten jom... 20 vjet kom punu në Ent Pedagogjik, 20 vjet. Ni... e kom bo ni digresion t'vogël e kom bo. Dola me gruan time dhe me fmitë në Gërmi edhe po e takoj profesor Gazmend Zajmin. Ai sa i madh ai njeri o zot, o zot. Vëllau jem ka punu sekretar në Akademi të Shkencave 36 vjet, prej themelimit. Ka qenë shoqatë e

derisa u pensionu ka punu aty. “Bac”, se ai ma i ri se unë, “Gazmend nuk ka as prej shqiptarëve anej në Shqipni sa i zoti osht”.

Profesor Gazmendi kur isha unë aty nganjëherë... e ka dashtë sportin, ping pongun, e ka dashtë muzikën. Ka edhe kshtu, ka kompozue. Po i thom... u shpall ni konkurs në rektorat. Ai ishte tash rektor i Universitetit të Prishtinës. U shpall ni konkurs. Ky Mahmut Gërmizaj, keni dëgju Drita Gërmizaj ajo spikerja? Po Mahmuti ka punu në rektorat edhe e lëshoj atë detyrë. Unë shpreha dëshirën me shku në rektorat. Po i thom profesorit qishtu qishtu. Tha, “A je i interesun?” “Po”, thashë, “jom i interesun”. Pa e pytë Halimin hiç (qeshë). Tha, “Konkuro”.

Ka konkuru njani me magjistraturë, njo i Malit të Zi nuk e kanë pranë, mu më kanë pranë. Kom punu ni vjet këshilltar i mësimi universitar, kom punu. Mu lyn kta të Entit Pedagogjik Halimi e çojke ni dektilografe, “Shko bre thuj le të kthehet”. Ka qenë Enti Pedagogjik edhe kemi punu po ka qenë ni atmosferë që me shku me qef në atë Ent Pedagogjik. Edhe me ata të poshtrit... kshtuqë aty kom qenë. E lshova përsëri u ktheva në Ent Pedagogjik mas ni viti.

Anita Susuri: E qysh ka shku puna në Ent Pedagogjik gjatë viteve kur u bo diferencimi për shembull mas demonstratave? Sa ka qenë e vështirë?

Fetah Bylykbashi: ka qenë, kshtu, për shembull kur filloj kjo kushtetuta me u ndrru, kushtetuta kur filloj me u ndrru, a besoni, a besoni, asni shqiptar nuk ka kundërshtu përveç Fetah Bylykbashit. Ni shok e kom pasë të klasës, me ni bankë jemi ulë, i Deçanit. Katunin po ia harroj, i Deçanit. Ai, ai ka qenë... ma vonë kom ni, ai ish kanë me vijën e shtetit, po. Familja e tij ish kanë, po. Kur ka lexu kasetën që unë kom thanë, unë nëse Jugosllavia nuk na trajton të barabartë unë nuk e pranoj atë kushtetutë. Ai n’telefon po m’thurret, “A s’u bo ti hiç pa folë a? S’u bo pa folë a?” “S’u bo pra”. Kshtuqë nuk jemi qysh duhet, nuk jemi qysh duhet.

Qajo që thashë që 100 vjet i rujmë emrat e tjetër kujt, i afrimojmë emrat e tjetër kujt. I shkelim me dy kamtë... po i shoh tash edhe do njerëz që kanë fakultet e sene edhe nuk e respektojnë gjuhën shqipe, meniherë i përshtatën kësaj anglishtes. Për shembull support, support. Saherë po i ni po thom, “U t’u thaftë goja”, n’shipi me vete. Mbështetje, përkrahje, ndihmë, qysh të dush, shqip. Kaniherë po thom me dikond dikond po thom, “O’ gjuha shqipe po qan bre po qan për këto sene e na s’pe nina qysh po qan ajo. Na duhet me mbrojtë këtë gjuhë”.

Osht’ shumë ni gjendje, ni gjendje që kurrë s’po marrim vesh na qysh duhet. Qe tash m’falni edhe qit digresion po e boj. Edhe niherë emrin kallxoma?

Anita Susuri: Anita.

Fetah Bylykbashi: Anita. Serbët e kanë fenë e vet serbska vera, serbska vera, a po kupton? Mali i Zi e ka pasë me serbët derisa ishim në Jugosllavi. Tash u nda prej Serbisë edhe po thotë Cernagorška Vera. Greku thotë feja greke, bullgari thotë bugarska vera. Na çka jemi bre na? Çka jemi na? Pse na mos me përkrahë rilindasit tanë. Vaso Pash Shkodrani a e din çka ka thanë? Po t'kallxoj edhe pse ka thanë... Vaso Pash Shkodrani ka thanë, "T'u e pa rrezikun që po i gjet, rrezikun e..." ky, baba i gjuhës shqipe Kostandin Kristoforidhi.

Kostandin Kristoforidhi ka thanë, ju ka shkruar letër në Bukuresht Nicola Nacos atje e shoqatës shqiptare në Romani, "Amon na dërgoni libra sa më parë se nëse nuk hapim shkollë krejt shqiptarët e besimit mysliman po trajtohen si turq, krejt shqiptarët e besimit ortodoks po trajtohen si grek dhe krejt shqiptarët e besimit katolik po trajtohen si latin. Nesër kur të mësohet gjeografia e Shqipërisë do të thonë që këtu ka jetu në popull". Kur ka ardhë UNMIK ma së pari, tre vet kemi qenë shqiptarë. Rexhep Osmani, Fetah Bylykbashi dhe në Nazmi Caka. Me UNMIK, po. Kemi qenë aty.

Tash roli i UNMIK ishte vendimmarrës a i joni ishte këshillues deri në 2002-tën. Në 2002-tën u ndrrun rolet. Tani ata mbetën këshill dhënës e na vendimmarrës. Ka qenë njana prej tyre ka qenë njo e Pakistanit ka qenë ministër e financave. Ai na dojke shumë, na respektojke. Po shkoj me në koleg tjetër në Nazmi Cakën po shkoj në zyrë dhe këta 2002-tën kur i kom pasë 62 vjet. Po i thom, punojke në Jehona aty si përkthyes, po i thom, Jehonës, "Pyte bre qita çka domethanë emri Fetah. Unë i kom 62 vjet s'e di çka domethanë Fetah?".

Po i thotë tha, ia përkthej ajo Jehona, kur ia përkthej Jehona tha, "Çu çelsin e derës sille". Thashë çka po don me bo çelësin e derës. Kur e vnoj çelsin tha, "Fetah domethanë ti m'i vra 20 serb", ky po thotë. Se ai Fatihu ka qenë i tmerrshëm ai i turkut. Kshtuqë tani edhe ky Nazmija p'e vet ata tha, "E Nazmi çka domethanë?" "Nazmi nuk osht' në Kuran. Nazim po a Nazmi jo". Saherë folke thojke, "Le bre se ti s'ishe në Kuran", (qeshë). U mahnitke.

Pjesa e Katërt

Adea Batusha: A po kthehem te vitet e '90-ta për këtë këshillin organizativ pak me folë, protestat.

Fetah Bylykbashi: Po.

Adea Batusha: Për rolin tond pak me folë...

Fetah Bylykbashi: Po, po, po. Erdh vendimi prej Rugovës ka ardhë, prej presidentit dhe organeve tjera që gjithsesi ka nevojë m'u organizu në protestë gjithë populllore. Tash u caktun njerëzit, u caktun njerëzit, po. Na mue m'caktun Lidhja e Arsimitarëve m'ka propozu mu për kryetar të protestës me qenë, po. Shkojshim na tash secila parti politike sikur atë Flamurin. Flamuri ka qenë i Lidhjes Demokratike

po i ni zonës se disa zona i ka pasë Prishtina. Kshtuqë të gjithë ata edhe tash e caktum vendin në Partinë Fshatare, shpija e Ali Hadrit të madh. Ali Hadri profesor i historisë shumë i famshëm. Në shtëpinë e tij i mbajshim mbledhjet.

Vendimi, propozimi i të ndjerit të madhit, Rugova, ishte që protesta m'u mbajtë po protesta mos me shkakto gjakderdhje. Mos me shkakto gjakderdhje. Nëqoftëse vjen puna te gjakderdhja me u ndërpre. Çfarë ka ndodhë që edhe tri mbledhje në ditë i kom në këtë fletore edhe njo tjetër, bile ma e madhe se qisi formati osht'. Kah tri mbledhje n'ditë i mbajshim që t'jetë ni protestë shembullore që edhe armikun ta bojnë nervoz edhe e disiplinune. Emrat janë aty që i keni aty. Po.

Tash i mbajshim mbledhjet, Selatin Novosella ai ka qenë i burgosur politik, edhe ai ka kontribu përpara po. Ai merrte pjesë vazhdimisht si ndihmë me na dhanë, po. E kemi, tash, aty e keni te emnat janë do kllapa, do kllapa janë. Për shembull, Fetah Bylykbashi kryetar. E në kllapa atje n'fund osht' Fehmi Rexhepi, Fehmi Rexhepi doktor shkence osht'. Atëherë ka qenë. Se kem pasë, kem pasë planifiku që nëse Fetah Bylykbashi gjatë protestës arrestohet, e para, ose plagohet, e dyta, ose vrahët protesta mos me u ndalë tash me ardhë qiky Fehmia me vazhdu. Për të tanë i kem pasë kshtu organizimet.

Kjo ka qenë ni organizim i mrekullueshëm. Për zotin kur mal m'u bojke zemra kur i shihsha qetë qysh shkojke. Tash komanda që shkojke prej neve na që ishim në kryesi të lidhjes së protestës meniherë tash shkonte n'fund. Me telefon ma shpejt nuk kish shku. Si thojshim me u shpërnda, meniherë. Aty ka qenë ni surprizë ka qenë, ni surprizë. Kur shkum... se na në orën 12:00 e kem pasë terminin komplet kjo këshilli me shku aty m'i pritë kur vijnë protestuesit. E tash gjatë protestës, gjatë asaj orës, gjysë ore e kemi caktu me nejt para filologjikut. Mas gjysë ore me ecë në protesta n'kamë deri te kuvendi, deri ku të shkojmë.

Mrena qasaj gjysë ore dy herë ka ardhë policia. Unë s'i kom pa se na ishim rreshti i parë. Ka ardhë një, ia kom haru emrin, thotë, "Po të thurret ni polic qitu", nuk ish kanë nja disa metra, tri-katër metra. Po më kërcënohet. *"Naredujemo ti da ti narediš masi da se razide."* "Të urdhërojmë që ta urdhërosh ti masën të shpërndahet". Unë shumë qetë, *"Imamo svoj program i delovaćemo u skladu sa svojim programom."* "Na e kem programin tonë dhe do të veprojmë sipas programit tonë". Jom kthy prap unë te kolegët e tjerë. As pesë-gjashtë minuta nuk ka zgjatë përsëri kërcënimi i dytë, përsëri kërcënimi i dytë. T'njejtën kërcënim ma boni dhe t'njejtën përgjigje ia kom dhanë. Shumë qetë, shumë...

Kshtuqë pastaj kemi fillue na në ora 12:00 fiks. Unë vazhdimisht e kqyrsha... masi e paske pa ti në televizion edhe aty... bile ky, qysh e ka emrin ky, Sadiku, Sadiku i fakultetit të edukatës fizike. Thojke, "Kqyr profesor Fetahun qysh p'e kqyrë orën a osht' koha m'u nisë për me vazhdu". Neve na erdh ajo surpriza që deshta me thanë, na erdh Adem Demaçi, ndjesë pastë. Adem Demaçi ka qenë kryetar i Këshillit për të Drejtat e Njeriut kur u kthy prej burgut. E ka pasë atë çmimin që ia kanë dhanë. Ni autoritet që u bo shumë n'krejt botën. Po ai asni ditë s'ka qenë në mbledhje tona. Tash ai krejt

qëndrim tjetër e unë isha n'hall tash, isha n'hall para autoritetit të tij dhe para obligimeve që qysh i kishim bo na planin.

Ai qysh thojke ai, na u deshke me ia nisë me vrapu (qeshë). A na planin e kishim krejt ndryshe. Mirëpo, kurrë n'jetën time, Anita a? A p'e sheh? Anita, kurrë n'jetën time gradat që i ka fitu dikush t'hujat m'i qit' qitu {prek super}. Qato që i kom, t'mijat. Ai na ndihmoj shumë te Bankosi, te Rektorati aty. Kur shkum aty s'disa forca policore serbe aty, s'disa. Sikur mure e bonën. Na s'lojshim pe, na dojshim... po autoriteti se ai mu nuk m'ka njoftë policët. Ndonëse tash edhe njo këtu, ni t'vogël p'e boj se tani po tutna p'e harroj, qato ditë ni grue, grue e vllaut të bacit Ymer. Ma i vogli vlla, baci Ymer. Gruja e tij ka qenë prej kancerit në Beograd. Kur u kthy prej Beogradit ka thanë, "Baca Fetah, m'kanë pytë çka e ki qit' Fetah Bylykbashin? Mjekt më kanë pytë", po në shtyp e kanë pa.

Aty na ka ndihmue se edhe na po, po ai, autoriteti i tij na ndihmoj që... "Na i kemi, rruga nuk osht' veç e juja, rruga nuk osht' veç e juja po osht' edhe e jona. Prandaj, ju nuk keni të drejtë me na ndalë". U tërhoqën ata. Tash na i kem pasë, kena pasë njeri të posaçëm për informata, po. Një që ka qenë përpara në punë të brendshme, Rexhep Maqedonsi, po.

E kem pasë këtë, ofa bre, që ka, ka shkru këto, ky profesori Agni Dika, i ka shkru krejt ato transparentat e tash i ka nxjerrë ata studentët në qat' gjysë orën e parë që nejtëm aty. I kanë shpalosur, po. Ato i ka përgadit për krejt qendrat se shtatë qendra janë mbajtë, në shtatë qendrat e Kosovës me Prizren, me Gjakovë, me Ferizaj, me Mitrovicë, me Pejë. Në Pejë bile ni vajzës veshin ia patën kputë, veshin. E këtu jemi rujtë na me respektue këtë kërkesën e të ndjerit Rugova që t'mos bohet gjakderdhje.

Adea Batusha: E qysh ka mrri m'u bo qikjo? Me majtë për shembull turmën në kontrollë me thonë kushtimisht? Çfarë strategjie osht' përdorë?

Fetah Bylykbashi: Qe strategjinë, qitu që e kemi majtë na në shtëpinë e Ali Hadrit ata i kanë majtë nëpër lagjet e veta, po, po. I kanë majtë nëpër lagjet e veta. Flamuri për shembull në ata të Lidhjes Demokratike i ka majtë, po. Kshtuqë qishtu ka qenë organizimi.

Adea Batusha: Sa protesta janë majtë?

Fetah Bylykbashi: Janë mbajtë protesta ajo ka qenë dy ditore, dy ditore. Dy ditorja ka qenë protesta ka qenë kështu m'u nisë secili institucion m'u nisë para se me ardhë para filologjikut aty m'u tubu tanë. M'u nisë prej institucionit t'vet, prej fakultetit t'vet. Edhe qashtu e kanë zbatu, e kanë zbatu. E tash, të nesërmen kanë pasë për detyrë me shkue secili, jena kanë të caktun. Mu më caktun me shku te Gjimanzi Sami Frashëri me gjithë ni të Gjakovës. Ia harrova emrin bile ka vdekë ndjesë pastë, ni profesor i sociologjisë, po. Unë kom shku edhe aty ka ndodhë rrahja ka ndodhë, a kupton?

Adea Batusha: Ku?

Fetah Bylykbashi: Policia para Gjimanzit Sami Frashëri. Njani, ai drejtori i Sami Frashërit, e kishin rreh disa ditë ma herët ni Avdyl Gashin ka qenë drejtor i gjimnazit. Ai nuk e ka pranë qat' ditë me dalë në emër të drejtorit me dalë aty. E zavendësi i tij, zavendësi i tij e ka pranë. Tash shkum aty, bile e rrehën këtë zavendësin ashtu. Erdh ai zavendësi te unë thotë, "O baca Fetah", thotë, "ky kahre m'boni. Po thotë, 'Pse ti n'emën tem me dalë. Unë jom drejtor'", thashë, "Ku osht' bre ai? Ku jeni ju?" Jemi shku përte gjimnazit tash, ai tjetër gjimnaz që u bo atje, jo larg.

Janë do dyqane aty. Në dyqan aty p'e shoh Avdylin. "Avdyl çka ki?" "Pse ky?" "Po Avdyl a t'kemi thanë ty që drejtorët janë ata që duhet me dalë atë ditë në çdo institucion me dalë me mbrojtë. E ti s'e ke pranë. Na jemi pajtu se ti e ke hangër ni rreh atje e kemi prani. Ti në vend se këtij m'i thanë faleminderit që ma ke kry detyrën", thashë, "çka osht' kjo sjellje ksi soji?" Kshtuqë po them, ka pasë... e tash edhe tjetra që jom idhnu une me qita ni mbledhje e kena pasë mas qasaj që kena dalë në televizor e kena pasë ni mbledhje.

U morëm vesh që me shkru se kena pasë secili me shkru raport çka ka ndodhë atë ditë. Unë e kom shkru raportin tem qat' ditë çka ka ndodhë. Ma fortë u tutshin serbët mrena gjimnazit në ndërtesë sesa na. Se drejtori ka qenë serb këtu në Ivo Lola atëherë e ka pasë emrin te Sami Frashëri. Qishtu. Masanena du me ua cekë edhe shumë kund e kom përmend. Bile edhe me Flamurin dhe Sadikun. Ke festa, kur punojshim nëpër shtëpia private. Gjimnazi ka qenë atje te kjo, qysh po thirret atje, heronjtë a qysh p'e qujnë? Lagja e Trimave. Qatje e kanë pasë...

Anita Susuri: Në Vranjevc.

Fetah Bylykbashi: E në Vranjevc, bravo të qoftë. E në Vranjevc. Ishte festa e gjimnazit, dita e gjimnazit. Avdyli ishte drejtor. M'ka thirrë në mesin e atyre pasi që isha drejtor i Entit Pedagogjik m'ka thirrë edhe mu. E kom shku aty. Prej njerëzve t'mdhej të popullit tonë tre ishin aty. Ishte profesor Mark Krasniqi, ishte profesor Fehmi Agani. Fehmi Aganin e kom pasë profesor në normale, sociologjinë na ka dhanë, profesor në normale. Na kem pasë njerëz t'mdhej që na kanë dhanë. Ishte edhe vllau i Esat Mekulit, Hasan Mekuli.

Qe çka tregoj Hasan Mekuli atë ditë. Tha, "Kur kanë hy malazezët në Plavë edhe Gusi kur kanë hy malazezët në Plavë edhe Gusi me ushtri e kanë marrë edhe prifti, popin e kanë marrë. I kanë bo rresht shqiptarët, po, edhe ju kanë thanë, 'A po don me të vra a po don me pranë fenë ortodokse?' Ni prej atyne tash", kom harru a Omeragiç a qashtu diçka, po. Tha, "Ai nuk e ka pranë fenë dhe e vranë paradite e vranë. Tash vjen gruja e atij që u vra me dy djem vjen edhe i thojnë, 'A po don me pranë ti fenë krishtere apo po t'i vrasim djemtë?' Ajo e pranë fenë krishtere me i shpëtë djemtë po mas dreke vdes edhe ajo pika në zemër dhe varrimi paraditës u bo në varrezat krishtere, në të vërtetë muslimane se ai se pranojke", ai Omeragiç nashta edhe tjetër emër, e kom harru.

“Kjo e pranoj e tash ata e çun...” shumë barbare kta dhe janë të pangishtëm. Kta me pasë mundësi asni popull s’e lanë. Racë sllave ma e poshtër nuk ka. Nuk po i urrej pa arsye, pa arsye. Ni tjetër, ni mahallë qaty, ky banesën që e kom tash pak përte Furrës Qerimi shpinë e kena pasë na vllaznit. Tash ni kopsht i fmive bile u bo, ni kopsht në ballkon që po lujnë.

Adea Batusha: Qysh e ka emrin?

Fetah Bylykbashi: Nuk e di. E qajo shtëpi e jona ka qenë, e neve tre vllaznëve. Ka qenë në lagjen tonë veç ni serbe ka qenë, ka qenë farmacistë. Shumë e sjellshme. U shoqnojmë, edhe gruja ime u shoqnojke. Po, Anita, në orën 05:00 kur e lshojshim televizionin zjerm. Thuse i dul flaka Kosovës. Dilsha në ballkon e kqyrsha. Çfarë propagande kta dijnë me ba, kta janë të tmerrshëm. Qitu më erdh shpirti {prek hundën}. Shqipe, gruja ime e ka emrin Shqipe. Thashë, “Shqipe, kqyr çka po të thom, prej sotit nuk du me t’pa që shkon te Millanka edhe Millankën nuk e du në shpi. Pse Millanka nuk e çon zanin me thanë që me qita shqiptarë po jetojmë e kurrë ni t’keqe s’e kemi? Pse ajo s’e ngrit zanin? Kurrë s’du me e pa. A u morëm vesh?” “Po”.

Pra, me pasë fuqinë e Amerikës nuk i boj keq kërkujt. More mas dy dite a tri dite qashtu që isha i nxehtë t’u shku m’u taku na, Enti Pedagogjik ku e kishim atë ndërtesën. Këtë OSBE këtë shpinë e madhe p’e shihni OSBE që osht’ aty? Përfundi saj ka qenë ni serb i Pejës, bile shpija hala qashtu është e tij. Ai ishte zëvendës drejtor i Shkollës Naim Frashëri po atëherë Vladimir Nazor osht’ qujtë. Ka qenë zëvendës drejtor. Saherë shkojmë na këshilltarët edhe serbët vishin me neve se na me ni institucion ishim. U sillshim mirë edhe po më... unë t’u u lëshu te poshtë po më përshëndet mu. Unë s’dojsha me ia pranu as përshëndetjen.

Po ma bon, “Dober dan Fetah”, unë hiç. Kur m’tha të tretën herë thashë “*Prljaviju rasu od vas nisam video...*” “Racë ma e ndytë se ju nuk kom pa. Çfarë t’keqe po ju bojmë na juve që ju po na boni krejt këto? Asniherë ma s’ta du përshëndetjen tane as s’du me t’i pa sytë”. Ni koleg i joni i edukatës fizike, ni Luan Ramadani, ai e ka pasë vajzën në qat’ shkollë. Tha, “Me Luanin kemi folë për qito sene”, thashë, “Hiç s’po du”. Tjetra, Anita, tjetra plot ka pasë koleg, ka pasë koleg që kanë komunikuar me... unë ju kom thanë, “Qyre, e vetmja rrugë që unë komunikoj me serbin nëqoftëse organet tona prej Rugovës e te poshtë më caktojnë me shku me folë. Përndryshe që unë me ta, unë s’du me pasë komunikim sepse janë t’poshtër”.

Kemi shkue me autobus me vizitu këto në Marec i kena pasë ni shkollë. Flotacion quhej, ka qenë nifar’ grope atje. Kemi shku. Kanë qenë dy persona, dy biznesmen që na kanë ndihmu në Entin Pedagogjik ose me të holla ose me vetura të veta për me shku me vizitu. Na s’i kemi nalë vizitat nëpër shkolla. Jemi shku me autobus deri në Novobërdë. Kur kemi shku aty tash ma rruga anena katastrofë, s’ka rrugë. Jemi ngjitë në kamë tash për me shku atje poshtë. Kur kemi mrri ni kodër osht’ e kur kemi mrri pak pa ia fillu m’u lshu te poshtë erdh ni veturë me dymbëdhjetë polic. Na nalën.

“*Koje direktor?*” Thashë, “*Ja sam direktor.*” Ni Hysen Gashi i matematikës, ka vdekë ndjesë pastë, “Pse more?” Thashë, “O’ Hysen, nuk ka tash, nuk mundësh kërkushi m’u mshefë ti”. Po m’pytë ai po thotë, “*Kakvim planovima i zakonima radite vi?*” [Me çfarë plani dhe zakoni punoni ju?]. Thashë, “*Zna ceo svet mi radimo...*” “Na punojmë me ligjet e Kosovës dhe me planet e Kosovës punojmë”, ua kom thonë në ftyrë. Po shkojmë në qat’ shkollën qatje. “Në orën 12:00 jemi në Novobërdë me ardhë”, se qatëherë fillonte mësimi. “Kena me ardhë urdhnoni dhe na s’kemi me ndalë veprimtarinë tonë”. Anita, sa osht’ sahati se?

Anita Susuri: Kemi kohë.

Adea Batusha: Edhe gjysë ore.

Fetah Bylykbashi: Edhe gjysë ore. Pytni a kini diçka?

Anita Susuri: E çka ju ka ndodhë me ata policët qaty pastaj?

Fetah Bylykbashi: Nuk më kanë ngucë.

Anita Susuri: Ju kanë lëshu.

Fetah Bylykbashi: Po, kena vazhdu i kena kry hospitimin atje, po dhe jemi kthy. Mas kësaj protestës këtu ka pasë fillu edhe ni organizim tjetër me bo protesta tash nëpër qendra ku ka shqiptarë. Në Shkup e andej po nuk u realizu ajo.

Adea Batusha: E për Kosovë?

Fetah Bylykbashi: Në Kosovë, në Kosovë qat’ ditë kur janë mbajtë në Prishtinë janë mbajtë në Pejë. Me të njejtin program qysh i kena majtë na në Prishtinë, me të njejtat parolla, me të njejtat kërkesa. Edhe në Ferizaj, edhe në Prizren, edhe në Mitrovicë. Në shtatë qendra. Në shtatë qendra, krejt.

Adea Batusha: Në krejt kanë qenë dy ditore?

Fetah Bylykbashi: Po, po dy ditore, t’njejta. Konsiderohet se kanë marrë pjesë rreth 600 mijë njerëz, a po kupton? 100 mijë Prishtina i ka pasë, edhe këto tjerat. Prishtina e ka pasë Lipjanin e ka pasë Drenasin, e ka pasë Podujevën, e ka pasë Lipjanin, e ka pasë Novobërden. Krejt këta kanë qenë që i takojnë Rajonit të Prishtinës. Kshtuqë protestat janë mbajtë...

Anita Susuri: E cilat kanë qenë parollat, kërkesat për dikond që nuk i din?

Fetah Bylykbashi: Krejt i kemi të shkrune ato, i kena të shkrune.

Anita Susuri: Cilat kanë qenë për shembull kërkesat?

Fetah Bylykbashi: Po kërkesat kanë qenë, “Kërkojmë institucionet tona, shkollat tona, drejtat tona. Na punojmë me ligjet tona, nuk i pranojmë ligjet që janë shtypëse me karakter shtypës. Nuk i lejojnë drejt me i shfrytëzu të drejtat e barabarta shqiptarët”. Tash s’po më kujtohen dhe besoni që demenca (qeshë)... mirëpo i kemi të shkrune.

Adea Batusha: Unë veç edhe dy pyetje i kom për qit’ periudhë axha Fetah.

Fetah Bylykbashi: Urdhno.

Adea Batusha: E para osht’ për këtë monografinë që e përmendet edhe tjetra qysh e menon që ka ndihmu qito protesta situatën në arsim? A mendon që ka pasë ndikim? Ose çka ka ndrru?

Fetah Bylykbashi: Po qysh s’ka pasë...

Adea Batusha: Sipas teje kuptohet.

Fetah Bylykbashi: Jo sipas meje po sipas tanve. Se u vendos që na nuk do t’heqim dorë edhe do t’punojmë në shpia private po na nuk do ta mbyllim shkollën tonë që ishte dëshirë e serbëve, a po kupton? Mos me pasë bo qita Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë, s’po du pse kom qenë unë aty mirëpo besoni, besoni që me pasë, me pasë mbyllë shkollat tash mos me ju mbetë fmija gjysa e Kosovës ish shprazë. S’po thom krejt Kosova po ish shprazë. Na me qato shkolla i mbajtëm. Edhe parashkollorë ka pasë pak, nja dy-tre që funksionojshin. Tona shkollat punojshin. Me vështirësi po ia kemi dalë, ia kemi dalë.

Njo po ju tregoj, ndoshta ua kom tregu naj ditë tjetër. Na e kemi, testimet e nxanësve i kemi bo çdo vjet. Kur i kemi bo saherë i kemi bo tash kur i bojshim gati testet për me shku me ua shpërnda atje ku organizohet testimi, u deshke tash m’i rujtë se plot dokumente i zinte policia te dikush i ka zanë, a po kupton? Me qit’ Izjadinin që ka qenë, me Izjadinin natë e ditë kemi qenë bashkë. Ai e ka pasë ni inspektor, ni inspektor se organ ekzekutiv ka qenë ai. Unë i kom pasë dymbëdhjetë 13 këshilltar i kom pasë që i kom udhëheq në Entin Pedagogjik. E kemi pasë udhëheqjen edhe të mësimi lëndor edhe klasor.

Anita Susuri: Ishim t’u folë për protestat edhe krejt këto çka ka rezultu prej tyne.

Fetah Bylykbashi: Po thom de, ka rezultu që popullata osht’ bindë që ma me interes osht’ me vazhdu mësimi edhe pse në kushte të vështira edhe që ju bojmë thirrje që kush i ka hapësirë, si për shembull ky Aliu që e lshoj shtëpinë për Gjimanzin Sami Frashëri. Ai ka bo ni vepër shumë t’madhe, shpinë e re e

ka lshu. E kshtuqë u bind populli që na duhet me ndihmu njani tjetrin dhe mos me nalë punën tonë profesionale.

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: Deshta me ju pytë edhe për kohën e bombardimeve, a keni qenë në Prishtinë? A ju kanë kërku policia? Si ka qenë gjendja?

Fetah Bylykbashi: Kohën e bombardimeve kemi qenë në Prishtinë, po. Ka ardhë Esat Stavileci, profesori i juridikut. Ka ardhë në të vërtetë ai kishte shkue profesori Stavileci ka ikë prej banesës që ka pasë motra vet te Fakulteti Filologjik, jo filologjik po ksi elektro, Fakulteti i Inxhinierisë, po. Ai fakultet atje motra e saj qato te banesat që janë t’kuqet, ai ka ikë prej aty se aty e mor’ policia ata e zhvendosi aty. Ka ikë e ka shku te baba i kësajna, Dua Lipës, te Sait Lipa ka shku. Kojshi e kena pasë. Kur ka shku aty se dikur ishin kanë ktu poshtë në Dardani, ngat njani me tjetrin.

Gruja e tij... ai ka thanë, “E kom kojshi serbin, këtu nuk guxoj me marrë”. E tash erdh, tash i ka thanë profesor Esati, “Hajde kallxom kush ciat shpija janë tash prej shpisë tane deri anena te Furra Qerimi”, i ka thanë, “Osht’ Ditar Qamili, osht’ Daka, osht’ Sedat Dida, janë Bylykbashët”, “E”, thotë, “te qita Bylykbashët shko e që më pranojnë qita unë kisha shku”. Kur ju tregova në juridik juve që kam punu pesë vjet, ai qatëherë u konë martu, m’ka pasë thirrë n’dasmë me gjithë gru. Jemi kanë. Ku kom punu jom nda qysh osht’ ma së miri.

Erdh gruja e tij. Kur erdh ish mush frymë s’mujke me folë. “Zoti Fetah”, qishtu, qishtu mos t’i perseriti ato fjalë. “Zotni Esati ka thanë që kur i kena thanë Bylykbash që m’pranojnë ka thanë që që ka shku te ta”. Thashë, “Kqyre, shko thuj profesor Esatit unë s’kom garancion as për veti as për ty po derën çelë e ki mirë se vjen”. Esati ka ardhë edhe e ka pasë dhomën se e kena pasë shpijen me katër dhoma. Ditën e fundit 31 marsit, ditën e 31 marsit i ra atij me nejt nja tri ditë, katër ditë me nejt n’shpi teme, po.

Atë ditën e 31 marsit janë çue kur kanë ni që Esati osht’ te une, janë çue ka Rexhepagiçi profesori i pedagogjisë po ka ardhë se shpinë pak ma naltë e ka pasë. Kanë ardhë kta kojshitë, Sedat Dida me gjithë djalin me Agonin e kanë ardhë baci Ymer ka ardhë, e kanë ardhë kush, daja im, vllau i nanës ka ardhë me gjithë djalin e vet. Ka ardhë Murat Blaku, ni profesor i gjuhës shqipe në albanologji. U bo ni bisedë ashtu dhe janë çu me shku. Po sa kanë shku ata, po sa kanë shku ata kanë ardhë n’shpi për shpi kanë ardhë formacioni polic, paramilitar edhe ushtar. “Mrena shtatë minutave meniherë me shku në drejtim të stacionit të trenit”.

T’u bo aty mos vet. Ky vllau im e kish vjehrrën e vet me grunë e mikut t’vet edhe pesë fmi të tyne. Unë isha me vajzën se djalin e kisha i martun ai. B.B Poqin nashta e njihni, ai osht’ djali im. B.B Poqi. Ai ishte në lagjen tjetër me grunë e vet atje. Tash kanë ardhë nana e Shqipes, nana e Shqipes, e grusë me

gjithë vajzat e veta edhe me dhandrrin, “Hajde tash na me shku”, ata e kishin ni veturë, e kishin ni kombi edhe e kanë lut vajzën time që me shku me ta. Vajza u deklarua tha, “Unë nuk ndahna prej prindërve, unë nuk ndahna prej prindërve”.

Tash u murr vendim, ishim na dy vllazër se vllau i vogël ish në Gjermani. Tash ai që i kish ata plot, “Bac”, tha, “po nisemi qysh na kanë urdhëru me shku në stacion të trenit”, thashë, “Gjallë unë nuk po muj me ia kthy shpinën”. Po ai ka qenë shëndet ligë. Tha, “Po çka muj unë me bo a p’e sheh që e kom grunë teme e grunë e mikut e pesë fmi e dy vajzat e mija çka boj unë kshtu?” Edhe niherë e kom kqyrë shpinë, ia kom kthy dhe e kemi mbyllë shpinë e kemi shku në stacion të trenit. O’ zot i madh. Në stacion të trenit tamon ato sikur në kohën e nazizmit gjerman me jahuditë.

U sillshim. Kjo vajza ime, Ardianë e ka emrin. “Ardianë mos ta shofin ftyrën, kthe anej mshefe ftyrën”. Çka ki me bo? E ka armën. Kshtuqë hypëm në tren. Kemi mrri në 12:00 të natës në qat’ qysh po i thojnë aty ku osht’ treni? Ai katuni?

Anita Susuri: Ballaca?

Fetah Bylykbashi: Në Bllacë. Aty na kanë zbritë. Lindi tash 1 prilli, 1 prilli. Aty veç qielli kurgjo. As s’kishim... n’shi e n’ftohtë e në lloç e në baltë e tanat. Pesë ditë. Nuk lejojke policia maqedonase as ushtria maqedonase, hiç. Ardiana vajza, “Babë”, tha, “unë nuk e duroj ma këtë. Me do shoqe jena marrë vesh që na me shkue me depërtu”, aty bash ku ishin policia, ku ta di unë. Jom shku kom hypë me ni lis t’madh me pa vajzën ku osht’. Fatbardhësisht ia kish pasë ble vllau i vet në Londër që ishte ia kish pasë ble ni ksi me ngjyrë të kuqe, ni jakne. Ni jakne. E shifsha unë deri e kom pa derisa ka dalë anena.

Ajo i ka shfrytëzu që binin ushqim këta shqiptarët jepshin bukë e ujë e ku ta di unë, plot sene. Tash kur ka dalë anena i ka thanë, “Unë e kom babën edhe nanën edhe e kom axhën edhe e kom grunë e axhës”. Ajo tash vajza e vllaut, se e kena pasë ni prej Drenasit ni motër medicinale. Ajo mbetë në shpi tonë aty edhe ajo me neve. Qysh thirret ai katuni? Istogu mbiemrin ata. Qaty ku u kanë ai luftëtari i Drenicës. Ajo me nder’ prej juve, se kur ka dashtë m’u skaju pak për nevojë fiziologjike qishtu njerëzit {bën duart bashkë}. I ka rrëshit kama edhe kamën e ka lëndu shumë.

Tash e kanë thirrë kta që vishin, kta shqiptarët që na e bijshin ushqim e sene. Ju kanë njoftu atë ekipin shëndetësor e janë ardhë e kanë marrë me lese. Ajo ka lypë që mos me shku vet, e ka marrë vajzën e vllaut tim, vajzën e madhe. Ato vajzat që janë dalë anena janë organizu me qita të Maqedonisë, shqiptarët. I kishin pasë thanë, “Ajo ka thanë që e kom babë, nanën edhe axhën”. Kur erdhën ata tash i kishin bo do taktika kta shqiptarët. Kur erdhën i thanë Shqipës, pak pa u ofru ku duhet me dalë, unë lesën e kapa me ni anë, me ni anë ai shqiptari Fatmir emrin.

“Kur vijmë aty ngat aty ti gjëmo që je smutë shumë”. Qashtu ajo veproj kur dolëm anej i tha, “Boll tash, dolëm”. Tani autobusat i kishin organizu kta shqiptarët e me autobus qishte jemi nisë na. Ajo çika e vllaut kish shku me ata qysh i kanë çu atje kish shku në Strugë. Tash ka siguru banesa për neve atje. Kur, a u bo?

Anita Susuri: Jo, kemi edhe 15 minuta.

Fetah Bylykbashi: E mirë. Kur shkojmë na tash kur shkum në Shkup ishim bo ibret. Baltë e mos vet, tmerr, tmerr, tmerr. Ma së pari morëm ushqim tani hypëm me ni kamion të atyshit të shqiptarëve dhe na çun bash te ku osht’ ajo e shqiptarëve, qysh thirret ajo lagja në Shkup aty? Na dhanë ushqim edhe tash na po dojmë me u nisë, bile i nxorëm biletat për Strugë, po. I hypëm autobusit për me shku në Strugë se vajza e vllaut i kish siguru edhe për mu e për Shqipen edhe për vajzën. Kur kemi mrri te ky qyteti qysh e ka emrin ai qyteti tash?

Anita Susuri: Struga?

Fetah Bylykbashi: Jo, jo ma mrena.

Anita Susuri: Gostivar?

Fetah Bylykbashi: Gostivar, bravo. Në Gostivar kur kemi mrri policia, “Stop, nuk ka asnjë ma me shku. Urdhër kemi prej punëve të brendshme veç hajde tash me u kthy në Gostivar. Asni ma s’kena me çu”. Na zbritëm aty. Kur shkum aty kishin organizu ni improvizore ni kuzhinë me zi me ushqim e me mish e tonat. Edhe ato ulëset e thjeshta ishin, normal të thjeshta. Tash ishin organizue që qaty me qenë takimi i çdo muhaxheri. Na muhaxher u bom tani. Që vjen prej Kosovës aty. Tash kush don me pranë qata që i kanë lëshu venin e vet. Erdhën aty ni plak edhe ni djalë i ri. Ai plaku më mori mue edhe grunë time dhe vajzën. Ai i riu e mori vllaun tim me gjithë gru dhe ai i kish dy vajza.

Aty kemi ndejtë na kanë pritë si osht’ ma së miri. Kemi ndejtë nja 20 e disa ditë. Djali im prej Australisë erdh edhe po thotë, “Hajde”. Se tash kush dojke me shku kah t’dush. Aeroplanat, a po don në Amerikë a në Afrikë a? Nejse Afrikën kërkush s’e ka dashtë. A po shkon në Amerikën Jugore a në Europë ku të dush. Ai po thotë Arbnor e ka emrin. Tha, “Babë ju me ardhë me mamën edhe Ardianën me ardhë atje”, thashë, “O’ Arbnor tash nashta kthehemi”, tha, “Ani”, tha, “une në qoftëse bohet m’u kthy si të bohet edhe prej atjehit s’po të nali”, tha, “po ti a ma drejtë me ardhë te djali a te dikush tjetër?” “Qashtu po po presim pak”. Qishte.

Ky vllau shkoj në Gjermani se e kish djalin në Gjermani. Kshtuqë mbetëm une e Shqipja dhe vajza. Se tash vajza... vajza nguli kamë tha, “Une du me shkue”. Kta të ritë e kanë dashtë perëndimin, e kanë dashtë. Djali im u pat’ regjistru në fakultet, elektron e pat’ dhanë provimin edhe s’e vazhdoi, shkoj në Londër. Vajza tha, “Unë du me shku, du me shku te vllau”. Po tash me shku na, se tash, me 12 e diçka u

pat' hap tani, u pat' hap mundësia për me u kthy kush don me u kthy. Po ka qenë thirrja që mos u ktheni se ka mina, osht' rrezik i madh. Po aty e ka tregu populli shqiptar ni atdhe dashuri që s'i ka interesu edhe mina po po du me u kthy në vend temin.

Tash na me hi atje e hupke ajo të drejtën se kjo kish prej qasaj pozite që ishte e largune prej vendit kish të drejtë me shkue te vllau. Krejt ata na metëm deri me 13 gusht, krejt shkun, asnjo s'met aty. Po na shkum te vllau për Gjermani tash kta motra e Shqipës e nana e Shqipës e grusë ata shkun me ni fshat afër Tetovës, Odri. Aty e kanë pasë vajzën të martune edhe ata na thirrën niherë me shku atje. Shqipës normal nana e motra, e ku ta di unë. Na shkum atje.

Tash krejt u kthyn na metëm qat' shpijen e atina vllaut të motrës në atë shpijen ku osht' motra e martune po ata jetojshin në Prishtinë ama kish qenë aty vllau i tyne. Metëm me Shqipën deri me 13. Me 13 e kemi përcjellë në aeroport Ardianën për Sidney e kemi përcjellë në aeroport të nesërmen me 14 kemi ardhë në Prishtinë, merre me mend. Me 14 gusht kemi ardhë. Kshtuqë qishtu historia osht'.

Anita Susuri: Nëse doni me folë edhe për monografinë pak sa kemi kohë? Nëse doni veç.

Fetah Bylykbashi: Për monografinë të protestës?

Adea Batusha: Po. thatë që e keni publiku para dy viteve.

Fetah Bylykbashi: Po. kurgjo të re nuk ka, qato. Unë kur ta gjej muj me ua pru po qaty janë të shënune qata njerëz që e kanë udhëheq këtë protestë, krejt janë qaty të shënune. Edhe në qata që e kena prezantu atë ditë, monografia protesta të 12 tetorit '92-shes. Qaty osht'. Aty ka diçka, njani e ka shkru, Flamuri e ka shkru. Po kishte shkru atje qysh ilirët kanë organizu ku ta di unë do sene. Ato nuk përputheshin me qatë po s'osht' e tepërt edhe nëse e ka gjetë atë material. Edhe ai material osht' i dobishëm.

Anita Susuri: Mirë. Zoti Fetah, ju falënderoj shumë!

Fetah Bylykbashi: Unë juve ju falënderoj shumë ma shumë se edhe niherë po them Anita, i kom thanë dje, çka osht' me neve që... e po du me thanë që mirë po bohet që po evidentohet se dikur ka pasë disa njerëz që janë qenë, kanë qenë të gatshëm për çdo gjë edhe kontributi osht' dhanë edhe osht' vazhdu shkollimi. Shpesh herë po përmendet që qato ditë e krizës kanë qenë ndoshta ma serioze në punë bile unë ua kom dhanë ni kritikë. Se u pat' formue edhe ni komision kur ish ky Enver Hoxha ministër. U pat' formu ni komision për me hartu kurrikulën e re, kurrikulën e re për arsimin në Kosovë. Tash për këtë degën se unë në Ministri të Arsimit ku jom pensionu, aty jom pensionu. Unë kom qenë shef i edukimit para shkollor, unë kam qenë kryesori...

Adea Batusha: Prej cilit vit? Kur ke fillu? Meniherë mas luftës a?

Fetah Bylykbashi: Po mas luftës de. Qe prej cilit, 2002-shit. 2002-shin na jena ba vendimmarrës, tash organet tona. Qatëherë unë e kom këtë detyrë. Ato para se me u bo ajo mu m'i kanë pasë ngarku kta ndërkombëtarët detyrën e shkollave para shkollave. Shkolla fillore dhe shkollave speciale. Tash kisha eksperta prej UNMIK kisha. Kisha për specialet këto që ishin në Pejë e në Mitrovicë, atje në Prizren e ku ta di unë. Prej Australisë njo shumë i zoti. Kemi bashkëpunu shumë. Për këto pra... këto i kom udhëheqë shkollat fillore vazhdimisht ato drejtorët...

Mirëpo kjo ka qenë ajo faza kur na kemi qenë na këshill dhanës. E në 2002-ten në mars të 2002-tes janë ndrru pozitat. Ndërkombëtarët kaluan këshill dhënës e na vendorët i morëm detyrat. Në qat' kohë unë e kom marrë kta. Po përveç asaj që atëherë që kom, i pari që thashë, e kom kry detyrën e pedagogut në kopsht të fmise prej shqiptarëve, njo në Mitrovicë ka qenë ni serb. Mbete edhe... ju thashë që kena qenë në Shqipëri drejtorët e kopshteve të fëmijëve dhe edukatorët me vizitu Shqipërinë, ju thashë.

Kemi shkue prej Prishtinës, unë, drejtoresha Myrvete Limani, Sanija ni pejane motër medicinale edhe ni serb ia kom harru emrin, edukatore. Na të Prishtinës. Kanë shku prej Ferizajit serb, drejtori prej Lipjanit serb, drejtori prej Pejës serbe. Drejtoresha prej Prizrenit serbe, drejtoresha. Prej Mitrovicës serbe drejtoresha. Kanë shku edhe ka ni edukatore shqiptare ose naj motër medicinale dhe kemi shku atje. Kur kemi shkue, tash histori e gjatë osht', takimin e parë që e patëm me ni kopsht të fëmijëve kur dolën ata fmi qysh i kishin pregadit ai regjimi i Enverit. E bonën ni paraqitje fmitë as ushtarët e vërtetë...

Anita Susuri: Cili vit ka qenë?

Fetah Bylykbashi: Viti 1976-ten, '76-ten po. '76-ten në kopsht hala kom qenë, në '78-ten kom kalu në Ent Pedagogjik. A besoni po kushtet materiale katastrofë, katastrofë. Të parën vizitë, të parën vizitë e kemi bo në Ambasadën e Jugosllavisë. Ka qenë edhe ni tjetër, ni, kryesorja ka qenë kjo drejtoresha serbe e Prizrenit e grupit me gjithë njo prej Lidhjes Socialiste ka qenë e Kosovës ni shqiptare, ia kom harru emrin, po. Shkum. Ato kërkun që na duhet me shku në Ambasadë të Jugosllavisë me u paraqit. Ka qenë ni ambasador i Maqedonisë. Trajko Lipkovski m'duket nëse s'kom harru.

E mbajti ni fjalim, tha, "Na marrëdhانيت me Shqipërinë i kena pasë të kqija po kena fillu m'i përmirësu marrëdhانيت", tha, "tash profesorët e Universitetit të Tiranës po vijnë në Universitetin e Prishtinës, kta po shkojnë atje. Po vijnë të Titogradit e të Shkupit. Tregti kemi bukur të zhvillune e kemi tregtinë me Shqipërinë". Mirëpo fjalën e mramë e mbylli me, "Mos harroni se Shqipëria nuk i ka ndërpre shamjet kundër nesh". A din pse p'e përmendi kta? Se mu gjetë sikur atij Stanisa Markoviçit ministrit të arsimit, ministrit të arsimit që thashë, "A s'jom, as s'e urrej as s'jom i pa informum a po kupton?"

Kshtuqë shkum në Durrës. Kemi shkue, ku atje, kemi shku në, tybe po i harroj këto qytetet, në Fieri kemi shku. Aty tani kemi shku në, kjo, ofa bre, ai qyteti... shpija e Ismail Kadaresë...

Anita Susuri: Në Gjirokastrë.

Fetah Bylykbashi: Në Gjirokastrë. Nimom qashtu se po bllokohna. Në Gjirokastrë kemi shku. Kur kemi shku në Gjirokastrë ku kemi shku në ato kopshtet varfni, varfni e skajshme. Kur kemi shku në Gjirokastrë aty shkum në ni shkollë fillore që quhej Urani Umbo, shkolla shqiptare. Na thanë që tash e kemi pushimin e shkollës, a din, pushimi mes orëve që osht' pushimi. Thotë, "Kemi gjuhë shqipe, kemi gjeografi", kemi këta, kemi këta ato landët. Unë u shpreha me shku në gjuhën shqipe. Shkova.

Aty kur shkova unë me mu erdh edhe qikjo motra medicinale shqiptare. Erdh me mu kjo edukatorja serbe. Erdh drejtoresha e Lipjanit serbe. Erdh ky sekretari i kopshtit të fëmijëve të Ferizajit, erdh shqiptar, po. Edhe kush tjetër? E tash filloj ora e mësimit. Kur filloj ora e mësimit ish ni studente e saj e kishte kry shkollën e lartë pedagogjike, e kom dikund emrin. Ora e mësimit, njësia mësimore ishte vjersha e Migjenit, vjershat e Migjenit.

Filloj ora mësimore sipas metodikës që duhet. Me përsërit mësimin e orës së kalune e sene. Tash të orës së kalune i përsëritën disa vjersha. Po interesant këto gegnishten s'mujshin ata toskë, me vështirësi. Fatbardhësisht tash e kemi ni, e kemi ni gjuhë. Njëni prej nxanësve kur e recitoj vjershen e tha fjalën, "Seç na dërmuan titistët. Seç na dërmuan titistët". U kry ora e mësimit. Amo jemi nisë prej asaj shkolle për me shku në Hotel Çajupi. Bile turist i çujshin në turizëm, Hotel Çajupi për me ngranë drekë.

Në rrugë më kanë ndalë. Qajo kryesorja edhe kjo e Lidhjes Socialiste shqiptarja edhe kjo që ish kryesorja e grupit ajo serbja e Prizrenit. "Qysh ti mos me lëshu orën e mësimit? Ti ma i ngrituni prej krejt ktyne ke qenë, ti pedagog. Qysh ti mos me lëshu orën e mësimit?" Ama i bllokova. Thashë, po kjo drejtoresha jeme edhe ajo ish aty edhe shumë fer, shumë fer, ajo nuk foli, nuk foli. Thashë, "Ju lutem", thashë, "a e dini, a keni harru çka na ka thanë ambasadori i Jugosllavisë aty në Tiranë kur shkum në vizitë aty te ai? A ju kujtohet?" Thashë, "sikur si po m'thoni pse s'e ke lëshu orën me pasë lëshu orën m'kishit thanë a je normal? A tha ambasadori që shamjet Shqipëria s'i ka ndalë kundër neve?"

Çele guri gojën. Ma s'mujtën me folë. Drejtoresha, faleminderit prej saj, "Fetah, kur të shkojmë në Prishtinë mëngjes bon vaki t'parën kanë me ardhë kta të sigurimit me bisedu me ty". Qashtu ndodhi. Tha, "Po ti thuju atyne, urdhër prej drejtoreshës kom kurfar' raportimi unë mos me ju dhanë. Shkoni te drejtoresha ajo e bon raportimin qysh kemi kalu na në Shqipëri", a po kupton? Mëngjes erdhën. Në mëngjes erdhën. Unë kom pasë ni zyre, e pata bo ni bibliotekë e pata bo për mrekulli diçka. Tak, tak {onomotope} kur hyni, hyni njani që e vrajtën meniherë kta, Kllokoqi ai, Ibush Kllokoqi që e vrajtën kur erdhën, kur u shliku pak Kosova, po.

Ai Kllokoqi edhe erdh njo tjetër ni malazez. Ai nuk foli. Tha, "Si keni kalu në Shqipëri", tha, "ju?" Thashë, "Urdhër kom prej drejtoreshës që kurfar' raportimi mos me bo. Raportimin e ka marrë

përsipër drejtoresha dhe ka thanë krejt çka keni ju nevojë ejani te unë”. Shkun. Kërkush ma nuk... a u bo boll? (Qeshë)

Anita Susuri: Kurdo që doni ju. Faleminderit edhe niherë shumë!

Fetah Bylykbashi: Faleminderit juve shumë!